



Vlerësimi i ndikimit të krizës së Ukrainës në Kosovë

**Një ushtrim i
Parashikimit Strategjik
duke përfshirë projeksione
të bazuara në
skenarë**

Dhjetor 2022

Ky hulumtim u drejtua nga Dr. Peter J. Middlebrook, me modelimin dhe analizën e të dhënave nga Sharon M. Miller dhe Albana Vuji, dhe mbështetje diagnostikuese dhe koordinuese nga Amba Tadaa. Udhëzimi dhe mbështetja këshilluese dhe teknike janë ofruar nga Enisa Serhati, Andreas Nord, Blin Berdoniqi dhe Mimosë Velu nga UNDP-ja.

Ky publikim është porositur nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë dhe është prodhuar nga Geopolicity World. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk paraqesin domosdoshmërisht pikëpamjet e UNDP-së.

Përmbajtja

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	9
1. HYRJE	15
ARSYETIMI DHE QASJA E HULUMTIMIT	15
OBJEKTIVI DHE FUSHËVEPRIMI I HULUMTIMIT	16
METODOLOGJIA DHE KUFIZIMET	16
2. CENUESHMËRIA DHE REZILIENCA EKZISTUESE	18
3. KANALET, FAKTORËT DHE PËRFORCUESIT E TRANSMETIMIT	21
FAKTORËT, KANALET DHE PËRFORCUESIT	21
4. GJETJET E HULUMTIMIT TË NDIKIMIT	26
NIVELET BAZË TË TË HYRAVE TË EKONOMIVE FAMILJARE	27
BURIMET E TË HYRAVE TË EKONOMIVE FAMILJARE	28
KONSUMI I EKONOMIVE FAMILJARE	29
NDIKIMI I ÇMIMEVE TË ENERGJISË NË EKONOMITË FAMILJARE	30
NDIKIMI I ÇMIMEVE TË USHQIMEVE NË EKONOMITË FAMILJARE	31
NDRYSHIMET NË REMITANCAT	33
NDIKIMI NË BPV DHE BILANCIN TREGTAR	35
NDRYSHIMET NË TË ARDHURA DHE SHPENZIME	37
INDEKSI I ÇMIMEVE TË MALLRAVE BAZË	42
NDRYSHIMET NË ÇMIMET E MALLRAVE BAZË	42
NDRYSHIMET NË ÇMIMET E PRODHIMIT	43
5. PARASHIKIMI STRATEGJIK	44
SHTRËNGIMI GLOBAL I KAPITALIT RRIK KOSTON E HUAMARRJES	44
TË ARDHMET E KOSTOVE TË ENERGJISË	45
KRIZA MUND TË SFIDOJË KONTRATËN DHE KOHEZIONIN SOCIAL	46
A SJELL KRIZA TË MIRA TË PAPRITURA PËR AGJENDËN E GJELBËR	
DHE AGJENDËN 2030?	46
6. SKENARËT DHE PROJEKSIONET	47
SKENARI I SË ARDHMES SË INFLACIONIT TË ÇMIMEVE TË USHQIMEVE	47
SKENARËT E TË ARDHMEVE TË ÇMIMEVE TË ENERGJISË	49
SKENARËT E TË ARDHMEVE TË ÇMIMEVE TË MATERIALEVE	50
SKENARËT E TË ARDHMEVE TË RRIKJES DHE FISKALË	51
SKENARËT E TË ARDHMES SË SHPENZIMEVE INSTITUCIONALE	53
7. MASA PËR RISQET DHE ZBUTJEN	54
RISQET PARËSORE	54
MASAT PËR ZBUTJE	55
8. REKOMANDIME	57
ANEKSI 1: ANEKSI PËR TË DHËNA DHE STATISTIKA	58

Grafikë

Grafiku 1.	Hendeku i të hyrave ndërmjet Kosovës dhe anëtarëve të aspiruar të BE-së	19
Grafiku 2.	Burimet e të hyrave të ekonomive familjare (në %)	28
Grafiku 3.	Inflacioni mujor i çmimeve të ushqimeve (në %) që nga janari 2020	32
Grafiku 4.	Indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumit (2010-2022)	32
Grafiku 5.	Remitancat sipas kanalit (2021 (TM1) deri në 2022 (TM3) (milion euro)	34
Grafiku 6.	Totali i remitancave sipas gjashtëmujorit (2018-S1 2022) (milion euro)	35
Grafiku 7.	Aktualet (2018-2021) dhe parashikimet (2022-2026) e BPV-së nominale	36
Grafiku 8.	BPV tremujore (milion euro) me çmimet aktuale	37
Grafiku 9.	Të ardhurat e përgjithshme institucionale (ESA2010) (TM1 2020 deri TM3 2022)	38
Grafiku 10.	Shpenzimet e përgjithshme institucionale bazuar në ESA2010 (milion euro)	39
Grafiku 11.	Ndryshimi në përbërjen e shpenzimeve 2019, 2021 dhe TM1-TM2 2022	39
Grafiku 12.	Ndryshimet mujore të IHÇK-së sipas grupeve kryesore Janar 2018-Nëntor 2022 (në %)	42
Grafiku 13.	Çmimet e ushqimeve (Akt. 2011-2022) - (Parashikimi 2023-2026 - Mesatarja për 10 vjet)	48
Grafiku 14.	Çmimet e ushqimeve (Akt. 2011-2022) - (Parashikimi 2023-2026 Mes. për 10 vjet)	49
Grafiku 15.	Çmimet e energjisë (Akt. 2011-2022) - (Parashikimi 2023-2026 - Trendi për 10 vjet)	50
Grafiku 16.	Indeksi i çmimeve të materialeve ndërtimore (Akt. e TM 2013-2022, Proj. e TM4 2022) - (Parashikimi 2023-2026 - Trendi për 10 vjet)	51
Grafiku 17.	KAMSH i MFPT-së dhe FMN Të Ardhurat dhe Shpenzimet 2012-2021 (Aktuale) 2022-2026 (Projeksioni) (milion euro)	52
Grafiku 18.	Përbërja dhe projeksionet e borxhit publik (2017-2026)	52
Grafiku 19.	Deficiti buxhetor dhe nevojat për financim (2019-2025) (milion euro)	53

Tabela

Tabela 1:	Ndikimi në Kosovë i luftës në Ukrainë	22
Tabela 2:	Të hyrat vjetore të ekonomive familjare në Kosovë (%) sipas rajonit	27
Tabela 3:	Paga mesatare bruto dhe neto sipas vitit	29
Tabela 4:	Konsumi vjetor i ekonomive familjare në Kosovë sipas artikujve (%)	29
Tabela 5:	Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve të institucioneve për Buxhetin e Kosovës 2023	40
Tabela 6:	Supozimet e skenarit	47
Tabela 7:	Risqet parësore me të cilat përballet Kosova nga kriza e Ukrainës	54
Tabela 8:	Masat e propozuara për zbutje	55

VLERËSIMI I NDIKIMIT TË KRIZËS SË UKRAINËS NË KOSOVË

**Një ushtrim i Parashikimit
Strategjik duke përfshirë
projeksione të bazuara
në skenarë**

Dhjetor 2022

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Kosova¹ e gjen veten në disa udhëkryqe, të cilat të gjitha kërkojnë vendimmarrje komplekse politike, institucionale dhe investuese në kontekstin e ekonomisë së paqëndrueshme rajonale dhe globale. Çka e bën edhe më sfiduese sfidën e adresimit të çekuilibrave strukturorë dhe goditjeve ekzogjene, janë pasiguritë që lidhen me luftën në Ukrainë, dhe rezultatet e rritjes së ardhshme, të ardhurave dhe punësimit janë duke u rishikuar me ulje. Në këtë kontekst, ky hulumtim paraqet një analizë diagnostike të ndikimit aktual të krizës së Ukrainës në faktorë të ndryshëm, nga BPV-ja dhe remitanat, tek inflacioni energjetik dhe i ushqimeve dhe ndryshimi i përbërjes së shpenzimeve institucionale, ndërkohë që edhe përdor disa skenarë për periudhën 2022-2026, për ta përqendruar debatin në çështje kritike.

2. Ky raport shqyrton ndikimin e luftës në Ukrainë në çmimet aktuale dhe të ardhshme të energjisë, ushqimeve dhe materialeve, si dhe skenarët e ardhshëm të rritjes ekonomike dhe shpenzimeve fiskale dhe institucionale. Këta skenarë të ardhshëm janë tregues për udhëkryqet madhore të paraqitur në vijim me të cilat përballen institucionet qendrore në Kosovë, gjatë dimrit me sfida të konsiderueshme energjetike.

- ▶ **Kryqëzimi i Energjisë dhe Tranzicionit të Gjelbër:** Në një kohë kur siguria energjetike është agjendë parësore për Kosovën, e cila që mbetet shumë e varur nga sistemet e vjetra të prodhimit të bazuar në thëngjill, BE-ja po ecën me forcë përpara me Agjendën e Gjelbër të BE-së dhe dekarbonizimin. Teksa paketa e fundit prej 1 miliard eurosh nga BE-ja për të mbështetur tranzicionin energjetik në Ballkanin Perëndimor po ndihmon avancimin e tranzicionit, tranzicioni energjetik do të nxjerrë në dritë kufizimet e hapësirës fiskale dhe mungesën e shpenzimeve kapitale, duke çuar në të njëjtën kohë në çmime më të larta të energjisë, duke prekur veçanërisht të varfrit.
- ▶ **Kryqëzimi i të hyrave për kokë:** Gjatë 25 viteve të fundit, të hyrat për kokë në Kosovë janë rritur më shumë 900% - nga rreth 400 dollarë amerikanë në vitin 1995 në mbi 4,000 dollarë amerikanë në vitin 2022. Përkundër këtij progresi, të hyrat për kokë ende janë vetëm sa 12% qind e vlerës përkatëse në shtetin anëtar mesatar të BE-së ose 20% qind e vlerës së shtetit homologë të aspiruar. Rritja e të hyrave mund të ndodhë vetëm me produktivitet më të madh, rritje të inovacionit, përmirësim të konkurrueshmërisë, integrim të përmirësuar të tregut (për energjinë, por edhe tregtinë) dhe themele të forta për stimujt tatimorë dhe jo-tatimorë. Dështimi për të rritur të hyrat do të vazhdojë të jetë një faktor shtytës për të rinjtë që të ikin jashtë vendit (kryesisht Gjermani, Zvicër dhe SHBA). Kosova ka ngecur në grackën e të hyrave të mesme të larta, ku mundësitë që ka përdorur për të ecur përpara tanimë janë kthyer në pengesa ndaj avancimit.
- ▶ **Agjenda 2030 dhe Udhëkryqi i Varfërisë:** Teksa paga mesatare në Kosovë është rreth 500 euro për person në muaj, paga minimale është gjysma e saj, me shumë që jetojnë nën kufirin e varfërisë. Përmbushja e objektivave të Agjendës 2030 dhe eliminimi i varfërisë përmes rritjes gjithëpërfshirëse dhe të barabartë mund të arrihet vetëm përmes miratimit të një agjende reformuese progresive me mbrojtje sociale të targetuar, krijim të vendeve të gjelbra të punës, etj., në mënyrë që askush të mos lihet pas. Teksa rezul-

¹ References to Kosovo shall be understood to be in the context of United Nations Security Council resolution 1244 (1999).

tatet e rritjes kanë qenë historikisht të mira, ato janë të pamjaftueshme për të kapërcyer grackën e të hyrave të mesme të larta, për t'i nxjerrë qytetarët nga varfëria dhe për të adresuar sfidat e papunësisë, të cilat kanë anshmëri të fortë gjinore.

- **Kryqëzimi i hapësirës fiskale:** Me rritjen e subvencioneve sociale dhe të energjisë, janë reduktuar shpenzimet kapitale, duke ndikuar më tej në rezultatet e rritjes së ardhshme (siç është vërejtur nga institucionet financiare që rregullojnë projeksionet e rritjes). Teksa buxheti i Kosovës për vitin 2023 parashikon një deficit buxhetor të reduktuar deri në vitin 2025, deficiti aktual buxhetor nuk detajon se si do të financohen tranzicionet energjetike dhe digjitale, apo Agjenda 2030 me kosto përtej kapacitetit aktual fiskal të institucioneve qendrore. Në një kohë kur shtrëngimi i kapitalit global për të luftuar inflacionin po çon në kosto më të larta të huamarrjes dhe planet tranzitore me kosto të plota që ka gjasa të kushtojnë dhjetëra miliarda euro, miksi i borxhit dhe ekuitetit të investimeve të ardhshme bëhet e një rëndësie të madhe. Njëra rrugë çon drejt një buxheti të balancuar me reforma të kufizuara dhe shpenzime të ulëta kapitale, dhe rruga tjetër çon në rezultate të përmirësuar të rritjes të shoqëruara me deficite të vazhdueshme dhe borxh në rritje.

3. Ruajtja e një cikli virtuoz dhe gjithëpërfshirës të rritjes dhe investimit – zbutja e risqeve të rënies në një cikël vicioz të nën-investimit që çon në rritje, të ardhura dhe dividendë të ulët socialë – kërkon vendosjen e politikave të bazuara në dëshmi. Për këtë qëllim, gjetjet e hulumtimit të paraqitura këtu dhe projeksionet e bazuara në skenarë janë hartuar për të nxjerrë debatin dhe për të inkurajuar diskutimin se si të zgjidhet rruga më e mirë nëpër tranzicione/udhëkryqe të ndryshme, dhe çelësi i suksesit do të jetë forcimi i bazës së të dhënave, veçanërisht për ndikimet në nivel të ekonomive familjare. Në këtë drejtim, Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare 2017 duhet të përditësohet për të ofruar një panoramë më të qartë, pas ngjarjeve të pandemisë COVID-19 dhe luftës në Ukrainë.

4. Edhe pse gjetjet e hulumtimit theksojnë se në përgjithësi Kosova deri më tani ka qëndruar shumë reziliente ndaj ndikimit të luftës në Ukrainë, me remitanecat për shembull duke u rritur në nivelet më të larta historike, siç theksojnë të dhënat, ka gjasa që ende priten ndikimet më të mëdha të luftës në Ukrainë. Teksa çmimet e energjisë janë rritur masivisht, kufizimet e fundit nga ana e ofertës (si në aspektin e prodhimit të brendshëm të energjisë ashtu edhe në marrëveshjet rajonale të energjisë), si dhe dimri i gjatë, bartin riskun e rritjes së mëtejshme të çmimeve me ndikime negative si në produktivitet ashtu edhe në mirëqenien njerëzore. Ndikimi i inflacionit të çmimeve të energjisë si rezultat i goditjeve nga ana e ofertës është dallgë ekonomike që do të çojë në rezultate negative të BPV-së, papunësi dhe varfëri, marrë parasysh aftësinë e kufizuar të Kosovës për të paguar më shumë se ekonomitë evropiane për ofertën e energjisë. Me përkushtimin e Evropës për dekarbonizimin dhe lëvizjen drejt një miksi të energjisë alternative, gjetja e rrugës për tranzicionin energjetik në kontekstin e rritjes së borxhit, shtrëngimit të kapitalit dhe një deficiti fiskal dhe buxhetor, do të kërkojë hapësirë më të madhe fiskale seç disponohet aktualisht, pasi rregulla fiskale vendos kufirin e deficitit në 2% të BPV-së. Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) u dakordua për një përjashtim gjatë pandemisë, por rikthimi në rregull do të ndodhë në vitin 2023.

5. Siç theksohet në përmbledhjen e ndikimeve kyçe socio-ekonomike të regjistruara deri më tani (shih më poshtë), kriza tashmë ka ndikuar negativisht në çmimet e energjisë dhe ushqimeve dhe ka rritur deficitin buxhetor me shpenzimet që rriten më shpejt se të ardhurat, veçanërisht për shkak të subvencioneve të energjisë dhe kontributeve dhe benefiteve sociale. Megjithatë rezultatet e BPV-së dhe remitanecave ka vazhduar me trend pozitiv, rritja e shpenzimeve të ekonomive familjare për shkak të inflacionit të ushqimeve dhe energjisë vlerësohet tashmë në 9-18% për grupe të ndryshme të të hyrave dhe kjo pritet të rritet gjatë dimrit, me presion mbi çmimet e energjisë të kombinuar me kufizimet nga ana e furnizimit (dhe zinx-

hirët e furnizimit më të shkurtër) që çojnë në reduktime të mundshme të furnizimit me energji. Rritja e subvencioneve – siç ndodhi gjatë COVID-19 – duket se ekspozon trendet shqetësuese ku përforcuesit e brendshëm ndaj goditjeve të jashtme po gërryejnë rezultatet e rritjes, të ardhurave dhe shpenzimeve, teksa ushtrojnë presion në rritje mbi borxhin e brendshëm.

6. Teksa Deklarata Përmbyllëse për vitin 2022 e Misionit të Nenit IV thekson se të ardhurat më të forta fiskale ua kanë lejuar institucioneve qendrore të zbutin ndikimin e kushteve të goditjes tregtare tek ekonomitë familjare dhe firmat, duke rimbushur edhe tamponët e likuiditetit, parashikimet më të ulëta të rritjes nga Banka Botërore dhe OECD bëjnë thirrje për një shkallë të lartë kujdesi gjatë vitit 2023. Ndikimet kryesore socio-ekonomike të raportuara në tabelën e mëposhtme, të bazuara kryesisht në rezultatet e tremujorit të tretë të raportuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, ofrojnë dëshmi të ndikimit në Kosovë të luftës në Ukrainë.

Variablat kryesore socio-ekonomike	
Variabli i ndikimit	Ndikimi vjetor
Inflacioni energjetik	Shkalla e inflacionit për periudhën korrik 2021 - korrik 2022 e derivateve dhe lubrifikantëve për pajisjet e transportit ishte 44.1% dhe e lëndëve djegëse të ngurta, druve të zjarrit dhe peletit 43.5%, por këto nuk përfshijnë çmimet e energjisë elektrike. Për muajt nëntor 2021 – nëntor 2022, lëndët djegëse të ngurta, drutë e zjarrit dhe peleti kishin një shkallë prej 43.7%, ndërsa derivatet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit ishin më të ulëta në masën 21.3%.
Bruto Prodhimi Vendor	Teksa rezultatet e BPV-së për TM1-TM3 kanë treguar reziliencë, me kalimin e vitit institucionet financiare ndërkombëtare (FMN, BB) i kanë rregulluar me ulje projeksionet e tyre të rritjes së BPV-së. Që në maj 2022, FMN-ja vlerësoi se ndikimet e energjisë dhe ushqimeve në importet e Kosovës mund të jenë deri në 5.5% të BPV-së.
Të ardhurat institucionale	Gjithsej të ardhurat e përgjithshme u rritën për 3.5% nga 673.9 milionë euro në TM3 2021 në 697.5 milionë euro në TM3 2022, me FMN-në që raporton se të ardhurat më të forta fiskale ua kanë lejuar institucioneve qendrore ta zbutin ndikimin e kushteve të goditjes tregtare tek ekonomitë familjare dhe firmat, duke rimbushur edhe tamponët e likuiditetit.
Shpenzimet institucionale	Gjithsej shpenzimet e përgjithshme institucionale u rritën për 16.9% nga 526.9 milionë euro në TM3 2021 në 615.9 milionë euro në TM3 2022.
Subvencionet në Kosovë	Gjithsej subvencionet në Kosovë u rritën për 233.9% nga 42.2 milionë euro në TM3 2021 në 140.9 milionë euro në TM3 2022, kryesisht si rezultat i rritjes së subvencioneve për energjinë elektrike dhe rritjes së shpenzimeve për mbrojtjen sociale. Komisioni Evropian ka dhënë si grant 75 milionë euro për Kosovën për të mbështetur ekonomitë familjare dhe bizneset e cenueshme gjatë krizës energjetike në afat të shkurtër (1-3 vjet).
Programi i Mbrojtjes Sociale	Gjithsej shpenzimet e Mbrojtjes Sociale u rritën për 11.4% nga 137.7 milionë euro në TM3 2021 në 150.1 milionë euro në TM3 2022.
Indeksi i Çmimeve të Importit	Krahasuar me TM3 2021, çmimet e importit u rritën mesatarisht për 17.5% në TM3 2022.
Flukset e remitancave	Remitancat e TM3 2022 ishin 349.1 milionë euro, 13.6% më të larta se 307.4 milionë euro në TM3 2021, dhe më të larta se të gjithë tremujorët e mëparshëm.

Ndryshimet e kostos së jetesës së ekonomive familjare	Efekti i kombinuar i rritjes së çmimeve të energjisë dhe ushqimeve mund të vlerësohet ndërmjet 9.5% dhe 18% të buxhetit të ekonomive familjare.
Bilanci tregtar	Deficiti tregtar u rrit nga 361.1 milionë euro në nëntor 2021 në 401.4 milionë euro në korrik 2022, një rritje për 11.2%. Gjithashtu, eksporti i mallrave në nëntor 2022 është vlerësuar në 73.9 milionë euro, ndërsa importet janë vlerësuar në 475.4 milionë euro, që është një rritje për 4.6% në eksporte dhe 10.1% në importe, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021. Si eksportet ashtu edhe importet me BE-në u rritën përkatësisht për 32.3% dhe 7.8%.
Flukset e AZZH-së	Megjithëse nuk ka ende të dhëna për flukset e AZZH-së (Asistenca Zyrtare Zhvillimore) për vitin 2022, marrë parasysh riorientimin e AZZH-së nga partnerët zhvillimorë për t'u marrë me krizën e Ukrainës që solli mbi 9 milionë refugjatë, flukset AZZH/FTZ (Flukse të Tjera Zyrtare) për reformat kritike për vitin 2023 ka gjasa të jenë nën presion në rritje, duke ndikuar në reforma të tilla si ato të përshkruara në Programin e Reformës Ekonomike (PRE).

7. Duke u mbështetur në kontekstin e cenueshmërisë dhe reziliencës të përshkruar në seksionin 2, seksioni 3 ofron një pasqyrë të përmbledhur të sfidave të transmetimit, faktorëve kyç të transmetimit si goditjet e çmimeve ose ndikimi në kurset e këmbimit, si dhe përforcuesve vendorë. Faktorët e jashtëm përforcojnë pikat e forta ekzistuese, cenueshmëritë dhe reziliencën vendore ndaj ndryshimeve në ekonomi, duke çuar si në episode të përshpejtimeve të rritjes ashtu edhe të kthimeve pas. Përforcuesit vendorë janë politika dhe attribute strukturore ekzistuese që e përforcojnë ose zbusin efektin që ndryshimet në kushtet e jashtme mund të kenë në modelet e rritjes dhe akumulimit në sistemin socio-ekonomik të Kosovës. Në shumë raste, këta përforcues veprojnë si përshpejtues të ndryshimit (si pozitiv ashtu edhe negativ).

8. Seksioni 4 ofron një paraqitje të thelluar të të dhënave kyçe që janë thelbësore për hartëzimin e ndikimit dhe informimin e skenarëve dhe projeksioneve të bëra, për variabla të ndryshëm. Këto mbulojnë – në lidhje me inkuadrimin e ndikimeve sociale – kuantifikimin e bazës së të hyrave të ekonomive familjare, burimet e të hyrave të ekonomive familjare dhe atë që dihet për konsumin e ekonomive familjare nga grupe të ndryshme të të hyrave. Teksa të dhënat dhe analizat vijnë kryesisht nga Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare 2017, hulumtimi vëren se si COVID-19 ashtu edhe kriza aktuale e bëjnë atë nivel bazë një pikë referimi të dobët për ekstrapolimën e gjetjeve. Teksa mund të zbatohen supozimet, realiteti është se përditësimi i Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare në vitin 2023 do të jetë thelbësor për ta kuptuar plotësisht ndikimin e luftës në Ukrainë dhe tranzicionet e ardhshme energjetike në ekonomitë familjare të cenueshme.

9. Raporti dokumenton gjithashtu ndryshime në çmimet e energjisë dhe ushqimeve, ndryshimet në remitancat, ndikimin në BPV dhe bilancin tregtar, ndryshimet në të ardhurat dhe shpenzimet dhe çmimet e mallrave bazë dhe produkteve ushqimore. Analiza ofron bazën për zhvillimin e disa narrativave kyçe të parashikimit strategjik, siç përshkruhet në seksionin 5, si bazë për zhvillimin e pesë projeksioneve të ndryshueshme siç përshkruhet në seksionin 6. Këto projeksione mbulojnë (i) inflacionin e çmimeve të ushqimeve (ii) inflacionin e çmimit të energjisë (iii) skenarët e çmimeve të materialeve (iv) skenarët e rritjes dhe fiskal dhe (v) skenarët e shpenzimeve institucionale. Projeksionet bazohen në trendet historike dhe bëjnë supozime të qarta, siç përmbledhen më poshtë:

- **Skenari 1 (mesatarja për 10 vjet):** Trendi aktual vazhdon (inflacioni), institucionet ruajnë stabilitetin (vazhdon sipas trendit edhe pas 10 viteve). Projeksioni përdor ndryshimin mesatar të çmimeve që nga viti 2011.

- ▶ **Skenari 2 (ndryshimi i çmimeve në 2021):** Inflacioni vazhdon të përkeqësohet, recesion, kolaps i shpenzimeve institucionale (përshejtohet me normën për vitin 2021). Projektioni përdor ndryshimin e çmimeve për vitin 2011.
- ▶ **Skenari 3 (Mesatarja 2014-2018):** Kthim në trendet para konfliktit dhe pas COVID-19 (ri-fillon trendi i 5 viteve të fundit para COVID). Projektioni përdor mesataren e 5 viteve para COVID-19 (2014-2018)

10. Projektionet nxjerrin në pah disa trende shqetësuese që janë formuar prej disa kohësh, por që janë ngritur dhe/ose përshejtuara si rezultat i COVID-19 dhe krizës në Ukrainë. Në shumicën e rasteve, trendi për 10 vjet konfirmon sfidat e rritjes, rritjen e remitancave, rritjen e borxhit të brendshëm, rritjen e kostos së huamarrjes, inflacionin e çmimeve të ushqimeve të importuara dhe të mallrave të tjera bazë për shkak të mungesës së kapaciteteve prodhuese vendase, një reduktim të formimit të kapitalit fiks bruto dhe një rritje të barrës së subvencioneve të Kosovës dhe shpenzimeve për mbrojtje/mirëqenie sociale. Menaxhimi i të ardhurave dhe shpenzimeve në të ardhmen do të përfitojë nga rritja e investimeve publike dhe efikasiteti i financave publike (si operacionale ashtu edhe alokative) me një qasje koherente të financimit zhvillimor. Investimet e ulëta në ekonominë digjitale në zhvillim, në prioritetet e Agjendës 2030, hulumtim, zhvillim dhe inovacion, si dhe mungesa e thellimit të tregut financiar dhe atij të kapitalit, po e pengojnë si reziliencën ashtu edhe rritjen. Këto trende lejojnë të nxirren përfundimet e mëposhtme të gjera:

- ▶ **Të dhënat e përditësuara për shkallën e varfërisë dhe ndikimin e inflacionit tek ekonomitë familjare duhet të jenë qendrore për vendimet e politikave të ardhshme:** Gjetjet tregojnë se çmimet më të larta të importit të ushqimeve dhe energjisë kanë çuar në rritje të inflacionit, duke ndikuar negativisht në të hyrat reale të disponueshme të ekonomive familjare dhe duke ndikuar si në modelet e konsumit ashtu edhe në nivelet e kursimit. Marrë parasysh risqet e rritjes së kostove të energjisë nga dekarbonizimi, kur inflacioni po gërryen kursimet dhe vlerat e të hyrave, balancimi i tranzicioneve të ardhshme për të mbrojtur ata që mbeten pas kërkon qartësi se si të targetohen këta në mënyrë efektive.

Projektionet e rritjes së ardhshme, fiskale dhe të borxhit do të dukeshin jorealiste: FMN parashikon se gjysma e vendeve të Eurozonës po shkojnë drejt recesionit si pasojë e krizës energjetike dhe, marrë parasysh nevojën për të luftuar inflacionin, shtrëngimi i kushteve financiare do të vazhdojë në vitin 2023 dhe më tej. Edhe nëse Kosova ndjek një cikël investimi kundër-ciklik, marrë parasysh rritjen e shpenzimeve sociale dhe reduktimin e shpenzimeve kapitale, rritja e shpenzimeve mund të mbahet vetëm duke rritur nivelet e borxhit (edhe nëse ato qëndrojnë nën kufirin aktual ligjor prej 30% të BPV-së) dhe duke ekzekutuar buxhet dhe deficite fiskale më të mëdha. Fitimet nga formalizimi dhe rritja e arkëtimeve tatimore do të krijojnë gjithashtu presion ulës mbi bizneset, në një kohë të rritjes së shpenzimeve për energji dhe çmimeve të mallrave bazë.

Duhet të rriten shpenzimet kapitale për investimet publike dhe flukset private: Për të negociuar me sukses tranzicionet e energjisë dhe agjendave të tjera normative (ekonomia digjitale, Agjenda 2030, etj.) dhe për të kapërcyer grackën e të hyrave të mesme, do të duhet të rriten shpenzimet kapitale, ashtu si edhe mobilizimi i kapitalit privat. Hendekët në infrastrukturën fizike dhe sociale mbeten të konsiderueshëm, duke kufizuar investimet e huaja direkte. Me financimin e BE-së për Agjendën e Gjellbër që do të jetë vetëm pjesë e një miksi të ri të flukseve, do të nevojiten financime të reja të përziera dhe instrumente financimi të qëndrueshëm. Shumë prej tyre do të kërkojnë që të adoptohet Taksonomia e re e Gjellbër e BE-së së bashku me standardet për bonot e gjelbra dhe ato klimatike. Përshejtimi

i financimit për tranzicionet kritike do të kërkojë gjithashtu vendosjen e instrumenteve të reja të financimit. Duhet të hulumtohen instrumente të reja borxhi – siç janë “Instrumentet e Borxhit Kontingjent Shtetëror” (SCDI) dhe “Garancitë Sovrane të Lidhura” me BPV-në.

- ▶ **Vetëm një cikël virtuozy mund ta shmangë përkeqësimin e të ardhmes së borxhit:** Marrë parasysh përkeqësimin e kushteve ekonomike në Evropë, të shoqëruara nga kufizimet e Kosovës në menaxhimin e fushave kryesore të ekonomisë së saj si rezultat i statusit të saj, duhet të përmirësohen ndjeshëm normat e kthimit të investimeve publike dhe do të kërkojnë flukse të reja investimesh krahas reformave të përsheptuara. Për të adresuar pasiguritë energjetike, furnizimi më i besueshëm dhe më i gjelbër me energji elektrike ka potencialin ta zvogëlojë kostot fiskale dhe të biznesit, duke mundësuar gjithashtu kontributin e Kosovës në një të ardhme të dekarbonizuar, tashmë thelbësore për integrimin evropian. Kjo jo vetëm që do të thotë se programet për të zbutur ndikimin e rritjes së kostove të energjisë duhet të jenë të përkohshme dhe të targetuara, por do të thotë gjithashtu se institucionet qendrore duhet të balancojnë adresimin e çështjeve afatshkurtra, ndërkohë që ende investojnë në tranzicionet e nevojshme afatgjata. Teksa ligji i ri që rregullon pagat publike (që do të fillojë zbatimin e tij në 2023) do të rrisë vetëm paksa kostot e pagave, duke rritur subvencionet sociale dhe energjetike, detyrimet e tjera kontingjente dhe rezultate më të ulëta të rritjes duhet të menaxhohen përmes një politike të rritjes së investimeve, të lidhura me planifikimin më të mirë të investimeve. dhe rritje të përthithjes.

11. Ndikimi i krizës në Ukrainë thjesht ekspozon cenueshmërinë e Kosovës dhe Evropës ndaj goditjeve të sigurisë energjetike dhe ushqimore, megjithëse vërehen ndryshime në përbërjen tregtare. Teksa ndikimi në remitanat dhe BPV duhet ende të ndihet plotësisht (pritet një rënie ekonomike në mbarë Evropën), ndikimi në ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme të ekonomive familjare më të varfra ka qenë tashmë i madh, dhe vetëm mund të rritet. Me institucionet që tashmë kanë ndarë 100 milionë euro për të kompensuar rritjen e kostove të energjisë për ekonomitë familjare më të varfra, siç tregohet me rritjen e subvencioneve të theksuara më lart, kostoja e minimizimit të kostos njerëzore dhe të biznesit mund të çojë vetëm në borxhe më të mëdha dhe një rregullim të shpenzimit të buxhetit, që institucionet do të preferonin të mos ta bënin, në tranzicion nga COVID-19.² Në tetor 2022, BE-ja gjithashtu u zotua të ofrojë mbështetje të drejtpërdrejtë buxhetore prej 75 milionë eurosh për të reduktuar ndikimin e çmimeve të ngritura të energjisë në Kosovë, duke u fokusuar në targetimin e bizneseve dhe ekonomive familjare të cenueshme.³

12. Ndikimi i luftës në Ukrainë nuk do të dihet plotësisht për disa vite, me dimrin 2022/2023 që ka gjasa të jetë një nga më sfiduesit në histori. Humbjet e BPV-së (siç është vërejtur tashmë nga disa institucione financiare që gjatë vitit i rregullojnë projeksionet e rritjes), rritja e nevojave për shpenzime për subvencione për energji dhe ushqimore dhe mbrojtje sociale mund të jenë lehtësisht në magnitudë të ngjashme me burimet e nevojshme për të luftuar ndikimin socio-ekonomik të COVID 19. Institucionet financiare ndërkombëtare, BE-ja dhe partnerët dypalësh do të duhet të vazhdojnë të ofrojnë mbështetje fiskale dhe stimuj për të siguruar zbatimin e Agjendës së Gjelbër, gjatë një periudhe ku Kosova duhet të kalojë me kujdes në disa udhëkryqe, drejt një rritje të ardhshme më virtuoze, më gjithëpërfshirëse dhe të dekarbonizuar.

² Instituti Gap raporton se “Kosova ka ndarë 100 milionë euro për të mbështetur qytetarët kryesisht me pagesa të njëhershme prej 100 eurosh për të gjithë të punësuarit, pensionistët dhe studentët. Institucionet qendrore kanë subvencionuar energjinë elektrike me mbi 120 milionë euro, për të ofruar lehtësim për qytetarët, veçanërisht ata në nevojë; kanë alokuar fonde për rritjen e rezervave; kanë përforcuar subvencionet për kulturat kryesore bujqësore dhe kanë vendosur subvencionet e akcizës së naftës për fermerët.” Shih https://www.institutigap.org/documents/20407_Impact%20of%20the%20war%20in%20Ukraine%20on%20Kosovos%20Economy.pdf

³ https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/STATEMENT_22_6422

1

HYRJE

13. Pas problemeve socio-ekonomike të shkaktuara nga pandemia COVID-19, në shkurt 2022 shpërtheu lufta në Ukrainë, duke dërguar valë tronditëse të mëtejshme në mbarë botën, anembanë Evropës dhe Ballkanit Perëndimor. Teksa ndikimi i hershëm i luftës fillimisht u lokalizua në fqinjët e afërt të Ukrainës – me rreth 8 milionë refugjatë që u larguan nga Ukraina për në vendet e tjera evropiane që nga 10 janari 2023 – lufta ka çuar në një përçarje të madhe në çështjet ndërkombëtare dhe politikat e jashtme, për sigurinë dhe tregtinë. Lufta ka pasur gjithashtu një ndikim të thellë në inflacion, si dhe në shpenzimet ushtarake dhe borxhin publik.

14. Lufta në Ukrainë shpërtheu në një kohë kur çmimet globale të energjisë veç po rriteshin dhe bankat qendrore po avanconin shtrëngimin e tregut të kapitalit për të kompensuar inflacionin e shkaktuar nga një rritje e lehtësimit sasior, për trajtimin e pandemisë COVID-19. Për Kosovën, si pjesën tjetër të Ballkanit Perëndimor, ndikimet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe të shkaktuara u shpërndanë përtej fushës ekonomike, duke çuar në një rritje të tensioneve me Serbinë.

15. Në frontin socio-ekonomik, ndikimi i çmimeve të larta të naftës dhe ushqimeve, ndër faktorë të tjerë, ka pasur një ndikim të dëmshëm në koston e jetesës, duke e goditur veçanërisht rëndë kuintilin më të varfër të popullsisë. Teksa pozicioni fiskal i institucioneve qendrore dhe remitancat kanë mbetur të larta, lufta në Ukrainë ka çuar në një krizë të thellë energjetike në Evropë në fillim të asaj që do të ishte Marrëveshja e Gjelbër e BE-së dhe një shtytje e re e madhe për të siguruar Marrëveshjen e Parisit për Klimën. Megjithëse vendet evropiane janë shpesh eksportues të energjisë në verë, në dimër kur përdorimi fundor rritet ndjeshëm, tepricat e tregtueshme zhduken dhe kostoja për konsumatorët rritet ndjeshëm, siç ndodhi në rastin e vitit 2022 praktikisht. Teksa çmimet e ushqimeve janë ngritur nga faktorë të ndryshëm, ndikimi i rritjes së kostove të energjisë godet rëndë çdo industri dhe treg, në një kohë kur Kosova sapo është rimëkëmbur nga pandemia me rritjen që ua kalon humbjeve të lidhura me pandeminë në vitin 2020. Përgjigja publike ka qenë rritja e subvencioneve të targetuara dhe arritja e marrëveshjeve të reja për energjinë dhe ushqimet, dhe teksa ky hulumtim nxjerr në pah ndikimet e krizës së Ukrainës në Kosovë, një dimër të gjatë na pret përpara.

ARSYETIMI DHE QASJA E HULUMTIMIT

16. Marrë parasysh se hulumtimi fokusohet në përcaktimin sasior të ndikimeve të ndryshme të luftës në Ukrainë në mirëqenien socio-ekonomike të qytetarëve në Kosovë, premisa bazë për metodën e vlerësimit është se përderisa goditjet janë ekzogjene (edhe pse të theksuara nga cenueshmëritë para-ekzistuese) ato kanë edhe përforcues të rëndësishëm vendorë; kështu, ato rëndohen nga faktorë të brendshëm, marrë parasysh mungesën e qëndrueshmërisë ndaj goditjeve energjetike dhe ushqimore në veçanti. Për sa i përket përcaktimit të niveleve bazë për periudhën para luftës në Ukrainë është përzgjedhur 31 dhjetori 2021 si bazë për vlerësimin e largimit nga trendi.

17. Një numër i madh i faktorëve të mundshëm të transmetimit ka gjasa të ndikojnë në Kosovë (Shih Tabelën 1 më poshtë) – të vendosur kundrejt probabilitetit të aktualizimit të risqeve – nënvizon rëndësinë e identifikimit të faktorëve – dhe ndërveprimit ndërmjet faktorëve. Për shembull, në një kohë kur në nivel global Asistenca Zyrtare për Zhvillim (AZZH) dhe ndihma humanitare po ripërcaktohen për t’iu përgjigjur ndikimeve të krizës në Ukrainë, disponueshmëria e financimit për reformat në vazhdim, si ato që lidhen me Agjendën 2030, ka gjasa të ndikohet negativisht. Kjo i lë institucionet e Kosovës më të ekspozuara se më parë, teksa ato kërkojnë rrugën mes sfidave të reja dhe komplekse sociale dhe ekonomike, duke përfshirë raundet e reja të subvencioneve të energjisë për të zëvendësuar një kosto të rritur të jetesës në mesin e anëtarëve më të varfër të shoqërisë. Ndikimi në militarizimin, polarizimin dhe rreshtimet e reja strategjike në Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë midis akterëve joshtetërorë, remitancat dhe faktorë të tjerë, duhet të hartëzohen me kujdes për vitin 2023 dhe më tej.

18. Teksa spektri i faktorëve, kanaleve dhe përforcuesve vendorë të transmetimit të përshkruar në tabelën 1 më poshtë demonstroi ndërveprimin kompleks mes faktorëve (d.m.th. çmimet e larta të energjisë mund të rrisin koston e subvencioneve duke lënë mënjanë shpenzime të tjera të rëndësishme sociale etj.), pasi që rezultat i kësaj mbështetje duhet të përkthehet në rekomandime të zbatueshme dhe të realizueshme, ky vlerësim balancon kompleksitetin me thjeshtësinë. Nëse analiza është shumë komplekse dhe akademike, ajo do të ketë zbatim të kufizuar në botën reale. Megjithatë, nëse merret një qasje tepër e përgjithësuar (e thjeshtuar), rezultatet e hulumtimit nuk do të jenë mjaft specifike për të sugjeruar përgjigjet e politikave institucionale. Marrë parasysh mësimet e nxjerra nga menaxhimi i COVID-19 prej institucioneve të Kosovës, është e nevojshme përgatitja paraprake duke para-pozicionuar burimet për të mbrojtur të cenueshmit me të hyra më të ulëta dhe bizneset nga dimri i ashpër që po vjen.

OBJEKTIVI DHE FUSHËVEPRIMI I HULUMTIMIT

19. Objektivi është të ndërmerret një vlerësim i bazuar në dëshmi për ndikimin në Kosovë të luftës në Ukrainë, duke u mbështetur në burimet relevante të të dhënave, për të zbërthyer implikimet dhe opsionet e mbështetjes së politikave në dispozicion të autoriteteve dhe partnerëve zhvillimorë. Ky vlerësim u fokusua në përcaktimin sasior të ndikimit të krizës në rritjen e çmimeve të derivateve, energjisë dhe ushqimeve, ndryshimeve në rezultatet ekonomike dhe flukset e remitancave, konsumin dhe cenueshmërinë e ekonomive familjare, bilancin tregtar dhe kostot fiskale, dhe në masën e mundshme në ndikimin në flukset për AZZH.

METODOLOGJIA DHE KUFIZIMET

20. Në mënyrë ideale, modelimi makroekonomik mund të ndërmerret bazuar në një model të Ekuilibrit të Përgjithshëm (EP) për të kapur strukturën e ekonomisë dhe reagimin e sjelljes së agjentëve (firma, ekonomi familjare, institucione), nga aplikimi i një politike të caktuar (p.sh. tarifat ose taksat e importit). Megjithatë, mes faktorëve të tjerë, kufizimet e të dhënave paraqesin një problem në krijimin e një modeli të fortë EP nga i cili mund të nxirret analiza.⁴

21. Prandaj, qasja e adoptuar ka qenë mbledhja e të gjitha të dhënave për variablat kyç nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Ministria

⁴ Përdorimi i modeleve EP është i kufizuar kur të dhënat nuk janë të disponueshme ose kur nuk vlejné supozimet e mëposhtme: (i) ka konkurrencë të përsosur si në tregjet e mallrave bazë ashtu edhe në tregjet e faktorëve, (ii) shijet dhe zakonet e konsumatorëve janë të dhëna dhe konstante, (iii) të hyrat e konsumatorëve janë të dhëna dhe konstante dhe, (v) kur faktorët e prodhimit janë krejtësisht të lëvizshëm ndërmjet profesioneve dhe vendeve të ndryshme, (v) ka kthime të vazhdueshme në shkallë, (vi) të gjitha firmat operojnë në kushte të njëjta kostoje, (vii) të gjitha njësitë e një shërbimi produktiv janë homogjene, (viii) nuk ka ndryshime në teknikat e prodhimit dhe (ix) ka punësim të plotë të fuqisë punëtore dhe burimeve të tjera.

e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) për periudhën para 31 dhjetorit 2021 deri në fund të tremujorit 2 (TM2) dhe kur është e disponueshme tremujorit 3 (TM3), si bazë për dokumentimin e trendeve në performancën e variablave. Të dhënat, së bashku me punime të tjera diagnostikuese, kanë lejuar që të dokumentohen kanalet, faktorët dhe përforcuesit vendorë parësore të transmetimit, duke përfshirë një vlerësim të përgjigjeve të mëparshme dhe të propozuara të politikave institucionale.

22. Ndikimet e drejtpërdrejta si rezultat i luftës në Ukrainë (d.m.th. rritja e çmimeve të ushqimeve, risku dhe ndikimet e sanksioneve dytësore etj.) dokumentohen dhe përcaktohen në sasi sa të jetë e mundur, duke përdorur faktorët dhe kanalet parësore të transmetimit si pikat e hetimit. Ndikimet e tërthorta (d.m.th. kufizimet tregtare, inflacioni më i gjerë i çmimeve të mallrave bazë dhe kufizimet e zinxhirit të furnizimit etj.) duke përfshirë ndikimin e industrive lokale që blejnë mallra dhe shërbime, dokumentohen aty ku ka të dhëna. Ndikimet e nxitura janë reagimi i institucioneve të Kosovës ndaj një ndryshimi fillestar (efekti i drejtpërdrejtë) që ndodh përmes rishpenzimit ose rialokimit të buxhetit. Për shembull, kjo mund të jetë ndryshime në tatimet dhe subvencione pasi që kriza mund të ketë ndikime në AZZH dhe programet e mirëqenies publike, duke ndikuar në shkallën e varfërisë, si dhe duke pasur ndikime më të gjera (lidhjet prapa dhe përpara) me sektorë dhe popullata specifike.

23. Hulumtimi ka marrë gjithashtu të dhënat e vitit 2017 nga Studimi i Matjes së Standardit të Jetesës (SMSJ) dhe ka vlerësuar ndikimin e mundshëm në të hyrat e ekonomive familjare, ndër faktorët e tjerë. Rezultati është një qasje diagnostike hibride që nuk është një model EP/ÇF në vetvete, megjithëse ndikimet janë modeluar dhe trendet janë dokumentuar. Rezultatet janë paraqitur në seksionet 3, 4 dhe 5 më poshtë, me seksionin 6 që ofron parashikimin strategjik, skanimin e horizontit dhe skenarët, dhe seksionin 7 që ofron rekomandime për institucionet e Kosovës për ndikimet e mundshme dhe çfarë do të duhet të bëhet për t'i menaxhuar dhe zbutur, në skenarin më të keq.

2

CENUESHMËRIA DHE REZILIENCA EKZISTUESE

Implikimet ekonomike të luftës në Ukrainë bartin riskun ta minojnë më tej rritjen gjithëpërfshirëse dhe barazinë sociale dhe të rrisin presionin mbi një sistem të mbrojtjes sociale që ka nevojë të forcohet. Nxitja e përfshirjes sociale dhe lufta kundër varfërisë janë gjithashtu vlera thelbësore të agjendës shumëpalëshe të BE-së, dhe për këtë arsye, duhet të identifikohen zgjidhjet sociale të bazuara në treg për ata që kanë mbetur pas. Përkundër rritjes së konsiderueshme të shpenzimeve për mbrojtjen sociale në vitin 2022 (megjithëse shpenzimet për mbrojtjen sociale janë ende të ulëta sipas standardeve të BE-së), duhet të përmirësohet targetimi i alokimeve për nevojat e përfituesve për të zvogëluar riskun e pabarazisë në rritje.⁵ Teksa reformimi i sistemit të mbrojtjes sociale do të kërkojë përpjekje të konsiderueshme, rritja e subvencioneve dhe shpenzimeve siç raportohet si rezultat i pasigurisë energjetike justifikon një fokus më të madh në rritjen më gjithëpërfshirëse dhe zhvillimin e mëtejshëm të politikave të punësimit dhe tregut të punës, si dhe unifikimin e sistemit pensional.

24. Një burim i rëndësishëm i cenueshmërisë ekzistuese është mbështetja e lartë në ekonomitë evropiane dhe kufizimet në politikat makroekonomike diskrecionale (veçanërisht monetare/kursin e këmbimit). Statusi i Kosovës dhe pasojat e tij – jo më pak mungesa e një vlerësimi kreditor – janë faktorë që pengojnë shfaqjen e një ekonomie të fortë. Teksa përmirësimi i lidhshmërisë brenda Ballkanit Perëndimor, si dhe mes Ballkanit Perëndimor dhe BE-së, mund të ndihmojë në nxitjen e rritjes dhe punësimit, përballja me ndikimin e COVID-19, e ndjekur nga rimëkëmbja dhe tani ballafaqimi me inflacionin e ushqimeve dhe energjisë, minon shpenzimet kapitale që e mbështesin integrimin e mëtejshëm. Si rezultat, gjatë 25 viteve të fundit, të hyrat për kokë në Kosovë janë rritur më shumë 900% nga rreth 400 dollarë amerikanë në vitin 1995 në mbi 4,000 dollarë amerikanë në vitin 2022. Përkundër këtij progresi, të hyrat për kokë ende janë vetëm sa 12% qind e vlerës përkatëse në shtetin anëtar mesatar të BE-së ose 20% qind e vlerës së shtetit homologë të aspiruar.⁶

25. Në lidhje me ndikimin e faktorëve të transmetimit të përshkruar në Tabelën 1, duke përfshirë sanksionet, inflacionin, zhvlerësimin e euros dhe ndryshimin e kontekstit tregtar, ekziston një potencial për sfida ndaj kohezionit social dhe kundër-pretendimeve ndaj kontratës sociale, si dhe një risk brishtësie dhe potencial për dhunë. Në vitin 2019, Banka Botërore identifikoi tri risqe kryesore të lidhura me reziliencën, si më poshtë:

- ▶ Mospjesëmarrje ekonomike dhe politike, veçanërisht në mesin e të rinjve.
- ▶ Çështjet e pazgjidhura me Serbinë dhe marrëdhëniet ndëretnike, dhe
- ▶ Motivet dhe veprimet e akterëve të ndryshëm politikë që kapitalizojnë nxitësit strukturorë të brishtësisë.

⁵ <https://www.worldbank.org/en/news/press-release/2022/03/22/a-better-social-protection-system-can-help-kosovo-promote-human-capital-foster-productivity-and-reduce-poverty>

⁶ <https://www.worldbank.org/en/country/kosovo/publication/kosovo-cem>


26. Sipas Bankës Botërore, shkalla e varfërisë në Kosovë (e matur me 5.5 USD/ditë, PFB 2011) u ul nga 21.6% në 2017 në 16.7% të vlerësuar në vitin 2020, falë një performace të qëndrueshme pozitive ekonomike (rritja mesatare 3.4% në vit gjatë periudhës 2012-2017). Analiza e nxitësve të varfërisë ndërmjet viteve 2012-2017 sugjeron se një rritje e të ardhurave kontribuoi ndjeshëm në një ulje prej 6 pikë përqindje gjatë periudhës, pasi që punësimi është burimi kryesor i të hyrave për qytetarët me të hyra më të ulëta. Sipas “Strategjisë për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Informale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimin Financiar 2019-2023”, ekonomia informale në Kosovë është vlerësuar të jetë 31.7% në vitin 2017 (nuk është bërë vlerësim i mëvonshëm).⁷ Me një nga shkallët më të larta të informalitetit në Evropë, madhësia e ekonomisë hije dhe informale sigurisht që ndikon në të ardhurat institucionale, por gjithashtu ndikon në mbrojtjen sociale. Për më tepër, marrë parasysh se pjesëmarrja në fuqinë punëtore vazhdon të jetë kronikisht e ulët në 40.6% të popullatës në moshë pune në TM3 2021, dhe se varfëria dhe papunësia u rritën si rezultat i COVID-19 dhe mbylljes ekonomike,⁸ presionet inflacioniste historikisht të larta thuajse me siguri e rritën shkallën e varfërisë dhe reduktuan mundësitë e punësimit. Këta faktorë ndikojnë në implikimet e politikave të gjetjeve të paraqitura në këtë raport.

27. Sipas Bankës Botërore, të hyrat për kokë në Kosovë janë vetëm 12% e mesatares së anëtarit të BE-së ose 20%e shteteve homologë të aspiruar (Letonia, Estonia, Lituania, Republika Çeke dhe Sllovenia), dhe kriza aktuale e rrezikon përparimin e bërë së fundmi në largimin nxjerrjen e qytetarëve prej varfërisë dhe rritjen e të hyrave drejt të ashtuquajturve partnerë të aspiruar (shih grafikun 1 më poshtë). Adresimi i rritjes, të hyrave dhe papunësisë kërkon investime në produktivitetin e firmave dhe fermave, kapitalin njerëzor, eksportet, konkurrencën, si dhe stabilitet makroekonomik dhe qeverisje të shëndoshë. Ndikimi i krizës aktuale ndikon negativisht në shumë nga këto fusha.

GRAFIKU 1. HENDEKU I TË HYRAVE NDËRMJET KOSOVËS DHE HOMOLOGËVE TË ASPIRUAR VENDE TË BE-SË

Burimi: Banka Botërore, “Memorandumi Ekonomik i Vëndit për Kosovën, qershor 2022”

BPV për kokë 2009-19, US\$, Përqindje



⁷ <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/0211B611-A5EB-45F5-BE19-45A408D1DFA8.pdf>

⁸ https://databankfiles.worldbank.org/data/download/poverty/95142451-550D-4C1B-A389-26FD74C6B018QA-2019/Global_POV-EQ_XKX.pdf

28. Është e rëndësishme të nxirren mësimet nga plani i përgjigjes së institucioneve ndaj COVID-19, marrë parasysh se kriza energjetike vetëm mund të përkeqësohet (veçanërisht marrë parasysh infrastrukturën e vjetër të gjenerimit të energjisë) dhe edhe nëse inflacioni i çmimeve bie për ushqimet dhe produktet e tjera kryesore, çmimi i energjisë do të ndikojnë në të gjithë ekonominë, dhe në veçanti aftësinë blerëse dhe zakonet e pjesëve më të varfra të shoqërisë. Kanalet, faktorët dhe përforcuesit vendorë të ndryshëm të transmetimit të zhvilluar më poshtë, ofrojnë një pasqyrë se si transmetohen ndikimet në praktikë.

3

KANALET, FAKTORËT DHE PËRFORCUESIT E TRANSMETIMIT

29. Teksa rezultatet e vlerësimit (p.sh. ndikimi në inflacionin e çmimeve, në të hyra etj.) jepen në detaje në Seksionin 4, ky seksion dokumenton kanalet, faktorët dhe përforcuesit vendorë parësorë të transmetimit në Kosovë, që rezultojnë nga lufta në Ukrainë. Prandaj, kjo analizë identifikon faktorët kryesorë që ndikojnë në domenin socio-ekonomik, rrugët si ndikojnë këta faktorë në domenin socio-ekonomik, por edhe çfarë ndikimi kanë ata në ekonominë vendore, dhe pse ndikimi e ekspozon Kosovën në këtë mënyrë. Marrë parasysh se ky seksion përfshin një përmbledhje të përgjigjeve të politikave institucionale për adresimin e kërcënimeve dhe risqeve socio-ekonomike (d.m.th. rritja e shpenzimeve për mbrojtje sociale dhe për subvencione), ai gjithashtu ofron të kuptuar më të mirë të mënyrave si ndikojnë këta faktorë në elementët më të cenueshëm të shoqërisë.

FAKTORËT, KANALET DHE PËRFORCUESIT

30. Kjo analizë e përgjithshme jo vetëm që vlen për kërcënimet dhe risqet në zhvillim, por gjithashtu ofron njohuri të dobishme për përgjigjet programatike dhe rekomandimet e përgjithshme të angazhimit, për secilin faktor. Teksa institucionet e Kosovës mund të bëjnë shumë pak për të ndikuar në çmimet globale të energjisë dhe ushqimeve, ato mund të përmirësojnë analizën ex-ante të kostove në rritje, duke përfshirë investimin në masat zbutëse për të hequr vuajtjet e atyre që janë të ekspozuar ndaj një faktori specifik. Duke nxjerrë mësim nga përgjigja ndaj COVID-19, ku u përcaktuan intervenime që targetonin ata që ishin në risk më të madh, këto mund të aplikohen për rekomandimet përfundimtare. Megjithatë, për sa i përket përkufizimeve të koncepteve dhe mënyrës se si të interpretohet Tabela 1 më poshtë, duhet të theksohet sa vijon:

- ▶ **Faktorët e transmetimit:** Faktorët e transmetimit janë variabla të përcaktuar qartë si normat e interesit, çmimet globale të energjisë dhe ushqimeve, vlera e remitancave, kostoja e kredisë dhe faktorë të tillë si përfrimi politik me partnerët tregtarë, ndër faktorë të tjerë.
- ▶ **Kanalet e transmetimit:** Kanalet e transmetimit janë procesi përmes të cilit faktorë të ndryshëm ndikojnë në një ekonomi në përgjithësi dhe në nivelin e çmimeve ose të punësimit në veçanti. Mekanizmi i transmetimit mund të karakterizohet nga vonesa kohore të gjata, të ndryshueshme dhe të pasigurta dhe për këtë arsye shpesh është e vështirë të parashikohet efekti i saktë i një faktori të veçantë në domenin socio-ekonomik, sigurinë ushqimore ose kohezionin social, për shembull, ose të izolohet një faktor i veçantë, si p.sh. si inflacioni, i cili mund të ketë një sërë ndikimesh, duke përfshirë në grupet demografike dhe gjinore. Një kanal transmetimi përshkruan si ndikon një faktor në mjedisin e brendshëm.

- **Përforcuesit vendorë:** Faktorët e jashtëm përforcojnë pikat e forta ekzistuese, cenueshmëritë dhe reziliencën vendore ndaj ndryshimeve në ekonomi, duke çuar si në episode të përshpejtimeve të rritjes ashtu edhe të kthimeve pas. Përforcuesit vendorë janë politika dhe atribute strukturore ekzistuese (p.sh. varësitë tregtare, faktorët e përjashtimit gjeohapësinor, demografik dhe gjinor, etj.) që e përforcojnë ose zbusin efektin që ndryshimet në kushtet e jashtme mund të kenë në modelet e rritjes dhe akumulimit në sistemin socio-ekonomik të Kosovës.

31. Tabela 1 më poshtë ofron rezultatet e hulumtimit për faktorët, kanalet dhe përforcuesit vendorë parësorë të transmetimit për Kosovën, si rezultat i luftës në Ukrainë. Këta faktorë përfaqësojnë ndikimet më të dukshme dhe më të vëzhgueshme, megjithëse mund të ekzistojnë edhe faktorë të tjerë më të paprekshëm (p.sh., ndryshime në politikën e jashtme dhe aleancat e jashtme etj.).

TABELA 1: NDIKIMI NË KOSOVË I LUFTËS NË UKRAINË		
Faktori dhe përshkrimi	Kanalet e transmetimit	Përforcuesit vendorë
Sanksionet: Kufizimet e importit dhe eksportit në Rusi, duke iu shtuar masave për Krimenë që nga viti 2014.	Tregtia ndërmjet Kosovës dhe Ruisë është e kufizuar dhe si rezultat, ndikimi i drejtpërdrejtë i sanksioneve ishte i vogël. Megjithatë, embargoja e BE-së ndaj naftës së papërpunuar ruse në shkurt 2022 ka ndikuar në sigurinë energjetike së bashku me sanksionet e BE-së mbi teknologjinë, naftën dhe energjinë, transportin dhe furnizimet me ndikim në aviacion.	Një ndikim i madh i krizës në Ukrainë dhe sanksioneve të lidhura me to, ka qenë forcimi i pozicioneve historike gjeopolitike. Sipas FMN-së, teksa kanalet e drejtpërdrejta tregtare dhe financiare me vendet e prekura nga lufta janë të papërfillshme, ndikimi i rritjes së çmimeve ndërkombëtare të ushqimeve dhe energjisë në importet e Kosovës mund të jetë deri në 5.5% të BPV-së.
Indeksi i Çmimeve të Energjisë: Ndikimi i krizës dhe sanksioneve ka çuar në rritje të madhe të çmimeve globale të energjisë.	Eksportet ruse të naftës së papërpunuar dhe të produkteve të naftës në Evropë, SHBA, Japoni dhe Kore ra për gati 2.2 miliardë mb/d që nga fillimi i luftës. Inventarët globalë të mbiservuar janë tkurrur, në Evropë është aplikuar ndërrimi i derivatit, dhe kërkesa në rritje gjatë dimrit do të bëjë që çmimet evropiane të energjisë elektrike të arrijnë nivele të reja rekord. Kjo ka çuar në një faturë më të madhe të importit të energjisë elektrike.	Sektori energjetik i Kosovës është zhvilluar për të prodhuar energji bazë nga linjiti, dhe duke u mbështetur në 2 termocentrale primare të cilat janë të vjetruara dhe jofleksibile. Në ambicien e saj për të diversifikuar prodhimin e energjisë, Kosova synon të ketë 32% të konsumit të saj të energjisë nga burimet e ripërtërishe, por aktualisht i mungon kapaciteti i baterive për ruajtjen e energjisë solare ose të gjeneruar nga era. Teksa prodhimi i energjisë në mënyrë konvencionale është i mjaftueshëm për të mbuluar kërkesën, për shkak të impianteve të vjetruara dhe mungesës së deponimit, Kosova nuk mund të arrijë mbulimin maksimal të ngarkesës në muajt e dimrit dhe për këtë arsye varet nga importet për të përmbushur kërkesën vendore. Në shkurt 2022, Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) i rriti çmimet e energjisë elektrike për konsumatorët me konsum mesatar të energjisë elektrike mbi 800 kWh në muaj nga 2.89 euro në 5.9 euro (mbi 100 % rritje) dhe nga 6.75 euro në 12.52 euro për tarifën e lartë ditore.

		<p>Më 29 gusht 2022, Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO) ka dorëzuar një kërkesë të re në ZRRE duke kërkuar ngritjen e çmimeve, e cila u refuzua. Një kërkesë e dytë është dorëzuar më 5 dhjetor 2022, dhe rezultati është ende i pasigurt. Shkalla e inflacionit për periudhën korrik 2021 – korrik 2022 për derivatet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit, ishte 44.1%. Për periudhën nëntor 2021 – nëntor 2022, shkalla e inflacionit të derivateve dhe lubrifikantëve për pajisjet e transportit ishte më e ulët, në masën 21.3%. Teksa konsumatorët vendorë e dominojnë kërkesën, veçanërisht në dimër, kostoja shtesë do të ndikojë në grupet me të hyra më të ulëta. Mund të ketë nevojë për importe më të mëdha nga tregu HUPX, çmimet e të cilave do të pasqyrohen në rishikimin e ardhshëm të çmimeve të planifikuar për në shkurt. Institucionet ndanë 100 milionë euro për të zbutur ndikimin e çmimeve më të larta të energjisë për qytetarët, megjithëse kjo ka gjasa të duhet të rritet/zgjerohet. Në tetor 2022, BE-ja u zotua të ofrojë një mbështetje të mëtejshme buxhetore prej 75 milionë eurosh për të reduktuar ndikimin e çmimeve të ngritura të energjisë në Kosovë, duke u fokusuar në targetimin e bizneseve dhe ekonomive familjare të cenueshme. Rritja e çmimeve të energjisë në Kosovë si rezultat i luftës në Ukrainë ka rritur urgjencën për të investuar në prodhimin e qëndrueshëm të energjisë vendore dhe për të reduktuar varësinë nga importet e shtrenjta.</p>
<p>Inflacioni i çmimeve të ushqimeve: Ndërprerja e eksporteve të elbit, misrit, grurit dhe vajit të lulediellit nga Ukraina dhe Rusia (prodhuesit kryesorë të tregut global bujqësor).</p>	<p>Transmetimi i çmimeve përmes tregjeve globale të mallrave ushqimore. Kufizimet e eksportit/masat proteksioniste të vendeve të tjera prodhuese. Rritja e blerjeve nga vendet jashtë Rusisë dhe Ukrainës.</p>	<p>Autoritetet e Kosovës veç kishin filluar të merren me rritjen e çmimeve globale të ushqimeve në fund të vitit 2021. Shkalla e inflacionit për periudhën korrik 2021 – korrik 2022 ishte 14.2%, megjithëse rritja e çmimeve në produkte të caktuara e ka tejkaluar ndjeshëm këtë nivel. Vajrat ushqimorë u rritën për 54.1 %, buka dhe drithërat (32.1 %), qumështi, djathi dhe vezët (26.3 %), sheqeri, çokollata dhe ëmbëlsirat (19.1 %) dhe kafeja dhe çaji (16.8 %). Për periudhën nëntor 2021 – nëntor 2022, shkalla vjetore e inflacionit ishte 11.6%, e jashtëzakonshme, por ende më e ulët se majat e verës. Kjo shpjegohet kryesisht me vajrat dhe yndyrat ushqimore (34.4%); qumësht, djathë dhe vezë (24.7%); bukë dhe drithëra (21.9%); mish (21.2%); sheqer, reçel, mjaltë, çokollata dhe ëmbëlsira (18.3%); dhe salca, erëza, kripë, ushqime për fëmijë etj. (17.2%).</p> <p>Institucionet janë përgjigjur me rritje të subvencioneve për inputet bujqësore, bonuse në paga dhe rritje të përkohshme të përfitimeve pensionale dhe transfere sociale.</p>

		Gjithashtu, është duke u diskutuar për mundësinë e lejimit të tërheqjeve të para-kohshme (deri në 30%) nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK).
Risqet e monedhës/kursit të këmbimit: Euro ka humbur 20% ndaj dollarit që nga fillimi i vitit 2022 dhe po tregtohet afër barazisë.	Kosova është e ndjeshme ndaj importimit të inflacionit si rezultat i zhvlerësimit të monedhës, një rezultat i euroizimit të ekonomisë. Normat më të larta ndikojnë në nivelet e borxhit dhe kostot e kredisë. Megjithatë, euroizimi i sistemit financiar mund të shihet edhe si një burim i përgjithshëm i stabilitetit financiar.	Zhvlerësimi i monedhës do të gërryejë të hyrat e grupeve me të hyra të mesme dhe të ulëta, në të njëjtën kohë duke rritur kostot për energji, ushqime, mallra bazë dhe shërbimeve, duke rritur koston e jetesës dhe duke ulur kursimet. Ndër faktorët e tjerë, zhvlerësimi ka sjellë uljen e vlerës reale të pagës minimale, duke çuar në një diskutim institucional për rritjen e pagës minimale për afër 50%, por pa i rritur pensionet paralelisht.
Shtrëngimi i kapitalit evropian: Mund të ketë kushte më të ashpra financiare në Evropë	Teksa tregjet globale të kapitalit shtrëngohen për të adresuar normat historikisht të larta të interesit, kostoja e huamarrjes do të rritet duke ndikuar në shumë nga industritë në rritje të Kosovës	Rritja e normave të interesit të BE-së mund të përkthehet në norma më të larta të interesit të brendshëm, duke krijuar cenueshmëri për sektorët që janë zgjeruar fuqishëm, përfshirë ndërtimtarinë.
Vlerësimet e kreditit: Për shkak të statusit të Kosovës, është penguar aftësia për të marrë një vlerësim kreditor, duke minuar zhvillimin e tregjeve financiare.	Kjo redukton likuiditetin e tregut dhe ndikon negativisht në tregun e borxhit të brendshëm dhe aftësinë për huamarrje ndërkombe-tare nga tregjet e kapitalit	Ky kufizim para-ekzistues nuk ndikohet nga lufta në Ukrainë, por ndikon në funksionimin e tregjeve të kapitalit, portofoleve dhe flukseve hyrëse të tjera të investimeve të huaja.
Asistenca Zyrtare për Zhvillim: AZZH bruto u vlerësua në 556.7 milion dollarë në 2020.	AZZH mbështet reformat e politikave dhe infrastrukturën ekonomike dhe sociale, duke liruar hapësirën fiskale dhe duke mbështetur uljen e varfërisë dhe OZHQ-të. AZZH po riorientohet për t'u marrë me refugjatët ukrainas.	Megjithëse të dhënat për zotimet e AZZH-së për vitin 2022 nuk janë ende të disponueshme, kundrejt një BPV-je prej 9 miliardë dollarësh në vitin 2021, AZZH bruto përbënte rreth 6.1% të BPV-së. Riorientimi i asistencës së BE-së për t'u përgjigjur krizës energjetike dhe ridrejtimi i burimeve të përgjithshme të AZZH-së për t'u përgjigjur nevojave të njerëzve të zhvendosur nga lufta, së bashku me rritjen e shpenzimeve për mbrojtjen, ka gjasa të çojë në një ndryshim në fokusin dhe alokimet e AZZH-së.
Remitancat/transferet e emigrantëve: Remitancat nga diaspora e madhe e Kosovës kanë mbetur të larta me shifrat e gushtit 2022 që arritën nivelin më të lartë historik prej 131.6 milionë eurosh, nga 110.2 milionë euro në gusht 2021 dhe 91.6 milionë euro në gusht 2020, ndërsa shtatori 2022 ishte sërish pak më i ulët në 102.6 milionë euro.	Remitancat nga jashtë ndikojnë në rezervat në monedhë të huaj të Kosovës dhe ofrojnë një fluks të drejtpërdrejtë financiar për ekonomitë familjare për të mbështetur koston e jetesës.	Shumica e ekonomive familjare mbeten të varura nga flukset e remitancave, dhe pasi që shumica e emigrantëve janë në vendet e BE-së, ndikimi i menjëhershëm i luftës në Ukrainë ka gjasa të ketë një ndikim të kufizuar në vëllimin e flukseve të remitancave, të cilat veç ishin reziliente gjatë krizës COVID-19. Megjithatë, 30% e diasporës së Kosovës jeton në Gjermani, dhe nëse Gjermania do të ketë një rënie ekonomike si rezultat i rritjes së çmimit të energjisë dhe kufizimeve në anën e ofertës, remitancat mund të ndikohen në vitin 2023.

<p>Borxhi (kostoja e huamarrjes): Shtrëngimi i kredisë globale nga të gjitha bankat madhore qendrore për të kontrolluar inflacionin</p>	<p>Rritja e inflacionit rrit kostot e huamarrjes, duke përkeqësuar përballueshmërinë e borxhit.</p>	<p>Teksa borxhi publik është i ancoruar sipas rregullës fiskale në 40% të BPV-së, nëse nuk zgjerohet baza tatimore, nuk forcohet transparenca fiskale dhe nuk zgjerohet baza e investitorëve, borxhit publik rritet së bashku me rritjen e kostos së huamarrjes.</p>
<p>Risqet gjeopolitike: Përshkallëzimi i tensioneve.</p>		<p>Risqet gjeopolitike janë përshpejtuar globalisht si rezultat i luftës në Ukrainë me implikime më të gjera për Evropën dhe Ballkanin.</p>

4

GJETJET E HULUMTIMIT TË NDIKIMIT

32. Bazuar në faktorët e ndikimit të përmendur në seksionin e mëparshëm, nxitësit e krizës socio-ekonomike janë çmimet e larta globale të ushqimeve dhe energjisë, presionet e përgjithshme globale inflacioniste dhe recesioni i mundshëm në vendet evropiane prej nga Kosova merr remitancat e saj, ku ajo eksporton, dhe prej nga merr financimin e saj bankar. Megjithatë, siç u përmend më lart, dhe siç e identifikon ky raport, shqetësim të veçantë nuk janë vetëm shkaqet e ndikimit, por edhe efektet e tyre në domenin socio-ekonomik. Përforcuesit vendorë si varësia nga remitancat, pasiguria për statusin ndërkombëtar të Kosovës, mungesa e një vlerësimi të brendshëm të kredisë, rruga sfiduese drejt anëtarësimit në BE, nivelet e larta të informalitetit dhe të hyrat ende të ulëta për kokë, kontribuojnë drejt një rrethi vicioz.

33. Që nga maji 2022, reagimi i institucioneve qendrore ndaj situatës ekonomike në zhvillim përfshinte (i) 100 milionë euro të zotuar për punonjësit, studentët, pensionistët dhe 40 mijë pako ushqimore (ii) 120 milionë euro për subvencionet e energjisë elektrike (iii) 10 milionë euro për të rritur rezervat e Kosovës (iv) 5 milionë euro ose 36 cent për litër subvencion për naftën në bujqësi, si dhe reduktimin e marzhit të fitimit të naftës dhe (v) dyfishimin e subvencioneve për kulturat kryesore bujqësore.⁹

34. Siç u theksua në seksionin e fushëveprimit dhe metodës të përshkruar më lart, ky hulumtim shqyrton ndikimin e krizës së Ukrainës në variablat kyç, duke përfshirë ndikimin tek mallrat bazë dhe prodhuesit. Rezultatet e raportuara pasqyrojnë të dhënat më të fundit të tremujorit të dytë ku janë raportuar, si dhe nga Studimi i Matjes së Standardeve të Jetesës (SMSJ) 2017, në mungesë të një alternative. Faktorët e mëposhtëm të ndikimit janë shqyrtuar, bazuar në të dhënat e disponueshme dhe analizat multivariate, brenda kornizës së asaj që dihet për të hyrat dhe konsumin e ekonomive familjare.

Ndikimi i çmimit të energjisë në ekonominë familjare

Ndikimi i çmimeve të ushqimeve në ekonominë familjare

Ndryshimet në remitancat

Ndikimi në konsumin e ekonomive familjare

Ndikimi në bilancin tregtar

Ndikimi në të ardhurat dhe shpenzimet

Ndikimi në çmimet e mallrave bazë

Ndikimi në çmimet e prodhuesve

⁹ Në maj 2022, Instituti Gap vlerësoi 'Ndikimin e luftës në Ukrainë në ekonominë e Kosovës'. https://www.institutigap.org/documents/20407_Impact%20of%20the%20war%20in%20Ukraine%20on%20Kosovos%20Economy.pdf

¹⁰ Në dispozicion në: <https://millenniumkosovo.org/wp-content/uploads/2018/11/MCC-Kosovo-Labor-Force-and-Time-Use-Study-Final-Research-Report-1.pdf>

NIVELET BAZË TË TË HYRAVE TË EKONOMIVE FAMILJARE

35. Sipas një studimi të kryer në vitin 2018, i titulluar “Raporti Huluntues i Studimit të Fuqisë Punëtore dhe Përdorimit të Kohës në Kosovë”, financuar nga Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit, të hyrat mesatare vjetore të ekonomive familjare në Kosovë ishin 5,496 euro, ku ekonomitë familjare urbane fitonin 6,230 euro dhe ekonomitë familjare rurale mesatarisht 5,300 euro (Shih Tabelën 2 më poshtë).

TABELA 2: TË HYRAT VJETORE TË EKONOMIVE FAMILJARE NË KOSOVË (%) SIPAS RAJONIT							
Rajoni	Mesatarja	<1000	1000-2000	2000-3000	3000-5000	5000-10,000	>10,000
Ferizaj	6,086	3.1%	12.0%	14.3%	25.8%	31.5%	13.3%
Gjakovë	5,642	3.3%	11.2%	17.7%	23.7%	29.4%	14.7%
Gjilan	5,482	6.6%	8.3%	14.8%	28.1%	29.8%	12.4%
Mitrovicë	4,133	10.3%	20.5%	15.8%	21.7%	24.9%	6.8%
Pejë	5,480	4.7%	12.0%	13.6%	23.6%	37.1%	9.0%
Prishtinë	6,487	6.0%	9.3%	13.6%	21.7%	30.2%	19.3%
Prizren	5,297	6.6%	10.2%	16.0%	27.7%	28.8%	10.7%
Average	5,497	6.0%	12.1%	15.2%	24.4%	29.9%	12.4%

Burimi: “Raporti Huluntues i Studimit të Fuqisë Punëtore dhe Përdorimit të Kohës në Kosovë”, MCS, (2018)

36. Ndonëse këto të dhëna janë të vitit 2018, gati 50% e totalit të ekonomive familjare të përfshira në anketë kishin të hyra totale vjetore të ekonomisë familjare në intervalin prej 3,000 euro dhe 10,000 euro. Rreth 24.4% e ekonomive familjare fitojnë në intervalin prej 3,000 euro dhe 5,000 euro, dhe 29.9% e ekonomive familjare fitojnë në intervalin prej 5,000 euro dhe 10,000 euro, mesatarisht. Teksa 6% e ekonomive familjare kanë të hyra vjetore prej më pak se 1,000 euro, 12.4% e ekonomive familjare kanë raportuar të hyra vjetore prej 10,000 euro dhe lart. Këto shifra janë para pandemisë COVID-19, e cila veç e minoi produktivitetin dhe punësimin.


37. Të hyrat mesatare vjetore të ekonomive familjare për 40% të pjesës së poshtme ishin 2,230 euro krahasuar me 8,859 euro për 60% më të lartë. Gjithashtu, u konstatua se të hyrat vjetore të ekonomive familjare të ekonomive familjare me kryefamiljarë meshkuj, në 5,196 euro, ishin më të larta se ato me kryefamiljarë femra, në 4,505 euro, dhe diferenca ishte statistikiqsh e rëndësishme. Ndryshime vërehen edhe nëpër rajone, ku Mitrovica karakterizohet me nivelet më të ulëta të të hyrave mesatare prej 4,133 euro dhe Prishtina me nivelin më të lartë në 6,487 euro, mesatarisht. Qytetarët në rajonet më të varfra do të ndikohen më shumë nga rritja e çmimeve të energjisë dhe ushqimeve, pasi shpenzojnë një përqindje më të lartë të të hyrave të disponueshme për komunalit dhe mallrat esenciale. Përqindja e ekonomive familjare me të hyra deri në 1,000 euro është më e larta në Mitrovicë (10.3%) dhe më e ulëta në Ferizaj (3.1%). Mesatarisht, 33.4% e ekonomive familjare në Kosovë kanë nivele të të hyrave deri në 3,000 euro, ku 46.6% e ekonomive familjare në Mitrovicë i përkasin kësaj kategorie. Sa i përket grupit të të hyrave prej 10,000 euro e lart, Mitrovica sërish qëndron më keq pasi vetëm 6.8% e ekonomive familjare raportuan se i përkisnin kësaj kategorie, ku Prishtina ka përqindjen më të lartë të ekonomive familjare, me 19.3%, që i përkasin këtij niveli të të hyrave.

BURIMET E TË HYRAVE TË EKONOMIVE FAMILJARE

38. Për të kuptuar ndikimin e luftës në Ukrainë në të hyrat, është e dobishme të identifikohen burimet parësore të të hyrave të ekonomive familjare, si më poshtë: pagat dhe mëditjet (publike dhe private), bizneset familjare, pensionet, remitancat dhe të hyrat e tjera (kredi, të paspecifikuara) (Shih grafikun 2 më poshtë). Për sa i përket zbërthimit, në vitin 2017 burimi kryesor i të hyrave ishin pagat dhe mëditjet në masën 51%, kreditë dhe të paspecifikuara 15%, bizneset familjare dhe pensionet (në 13% dhe 12%) dhe për fundi remitancat me 8%. Rënia e të hyrave nga ‘burime të tjera’ është pothuajse e kompensuar nga rritja në kategorinë ‘paga dhe mëditje, sektori privat’. Përndryshe, këto përqindje duken të jenë mjaft të qëndrueshme gjatë periudhës 2014-2017 dhe duke qenë se nuk ka të dhëna të disponueshme për periudhën 2018-2022, këto pika referimi përdoren si bazë për të kuptuar burimet e të hyrave.

GRAFIKU 2. BURIMET E TË HYRAVE TË EKONOMIVE FAMILJARE (NË %)

Burimi: a) Për vitin 2014-2015, ASK - Raporti Vjetor Statistikor (2016), Tabela 2, f. 7; b) Për vitin 2016-2017, ASK - Raporti Vjetor Statistikor (2018), Tabela 5, f. 17. Raportet e mëtejshme statistikore vjetore nuk kanë përditësime. Shënim: E kaltër = 2014, portokalli = 2015, e hirtë = 2016 dhe e verdhë = 2017



39. Raporti i ASK-së i cituar më lart konstaton se 20.2% e ekonomive familjare kanë pranuar remitanca nga jashtë Kosovës dhe se flukset e remitancave janë më të larta në zonat rurale, në 21.4% të ekonomive familjare, krahasuar me zonat urbane (16.1%). Nëpër rajone, përqindja më e madhe e ekonomive familjare që pranojnë remitanca është në Gjakovë (37.1%), ndërsa përqindja më e vogël është në Prishtinë, me vetëm 11.7% të ekonomive familjare që kanë pranuar remitanca. Mes pranuesve të remitancave, remitancat zënë mesatarisht 47.7% të të hyrave totale të ekonomive familjare, me një peshë më të madhe në zonat rurale me 48.4%, krahasuar me zonat urbane (44.6%). Familja mesatare pranuese e remitancave ka marrë 40% të remitancave si pjesë e të hyrave të tyre të ekonomisë familjare, me vlerën mediane për ekonomitë familjare urbane në 30% dhe për ekonomitë familjare rurale në 40%. Sipas rajoneve, kontributi më i madh i remitancave në të hyrat e ekonomive familjare u vu re në Prizren, meqë remitancat përbënin 57.6% të të hyrave totale të ekonomive familjare, për dallim nga Prishtina, ku remitancat kontribuuan vetëm me 36.6% në të hyrat e ekonomive familjare.

40. Sa i përket pagave dhe mëditjeve, dëshmitë tregojnë se në të gjitha kategoritë e punësimit janë rritur pagat nga viti 2016 deri në vitin 2021, përveç pagave të sektorit privat, të cilat u ndikuan shumë nga pandemia COVID-19, ndonëse në vitin 2021 u rikthyen mbi nivelet e

para Covid-it. Tabela 3 më poshtë tregon pagën mesatare bruto dhe neto sipas vitit, të kategorizuar, por nuk ka të dhëna të zërthyer sipas gjinisë, dhe këto mesatare në mënyrë të pashmangshme i maskojnë pabarazitë. Megjithatë, meqenëse kostoja e jetesës është rritur ndjeshëm gjatë kësaj periudhe, rritjet bruto dhe neto mezi kanë mbajtur ritmin me inflacionin.

TABELA 3: PAGA MESATARE BRUTO DHE NETO SIPAS VITIT								
Viti	Gjithsej		Sektori publik		Ndërmarrje Publike		Sektori privat	
	Bruto	Neto	Bruto	Neto	Bruto	Neto	Bruto	Neto
2016	422	382	525	467	686	609	340	310
2017	431	390	532	474	699	620	356	324
2018	453	409	573	509	721	639	376	342
2019	477	430	584	519	766	677	411	372
2020	466	416	624	552	769	680	380	342
2021	484	432	612	542	768	680	419	376

Source: ASK

KONSUMI I EKONOMIVE FAMILJARE

41. Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare 2017 ilustron pesë kategori kryesore që përbëjnë rreth 83% të konsumit (ushqimi, banimi, transporti, veshmbathja, alkooli dhe duhani).¹¹ Ushqimet dhe pijet përbënin 45% të të gjithë konsumit në vitin 2013, dhe kjo ra paksa në 40% deri në vitin 2017 (ku mishi përbën 20% të nëntotalit të tij dhe buka përbën 16%), që ndiqen nga banimi. Vetëm këto dy kategori përbënin 75% të konsumit total nga ekonomitë familjare në vitin 2013, dhe rreth 60% në vitin e fundit të raportimit (2017). Trendi i konsumit të ushqimeve ka qenë në rënie gjatë viteve, pasi që qytetarët u nxorrën nga varfëria dhe të hyrat më të mëdha të disponueshme ndikuan në zgjedhjet e konsumit. Megjithatë, duke qenë se nuk ka të dhëna të disponueshme përtej vitit 2017, për të vlerësuar ndikimin e rritjes së çmimeve në të hyrat e ekonomive familjare, do të konsiderohet se shifra për vitin 2017 (40%) është shifra aktuale për vitin 2022. E njëjta gjë do të supozohet edhe për banimin.

TABELA 4: KONSUMI VJETOR I EKONOMIVE FAMILJARE NË KOSOVË SIPAS ARTIKUJVE (%)				
Artikulli i konsumit (si % e totalit)	2014	2015	2016	2017
Ushqime	44	43	42	40
Pije alkoolike dhe duhan	4	4	4	4
Veshje	4	4	5	5
Banimi	28	30	29	29
Mobilje	4	3	4	4
Shëndeti	3	3	3	3
Transporti	5	4	4	5
Komunikimi	3	3	3	3
Rekreacioni	0	1	1	1

¹¹ Banimi përfshin ndërtimin ose rinovimin e një shtëpie, mobiliet, pajisjet elektroshtëpiake, dhënien me qira dhe shpenzimet e lidhura, siç janë faturat e energjisë elektrike dhe ujit.

Arsimi	1	1	0	0
Hotele dhe restorante	2	2	2	3
Tjetër	2	2	3	3
Gjithsej:	100	100	100	100

Burimi: AKS, Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare, 2017

NDIKIMI I ÇMIMEVE TË ENERGJISË NË EKONOMITË FAMILJARE

42. Megjithëse Kosova nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me tregjet e energjisë ruse apo ukrainase, pasi që nuk ka infrastrukturë të gazit, mungesa e kapaciteteve të besueshme të prodhimit vendor ka ndikuar si në furnizim ashtu edhe në kostot e furnizimit me energji. Në shkurt të vitit 2022, Zyra e Rregullatorit të Energjisë të Kosovës (ZRRE) ka nxjerrë aktin normativ për tarifën e energjisë. Çmimet në fuqi për konsumin deri në 800 kWh ishin 2.89 cent për tarifën më të ulët dhe 6.75 për tarifën më të lartë. Nga data 31 mars 2022 hynë në fuqi tarifën e reja si më poshtë: Tarifën për ekonomitë familjare për konsumin deri në 800 kWh në muaj do të mbeten të njëjta, ndërsa konsumi mbi 800 kWh në muaj do të faturohet me 5.9 cent gjatë tarifës së ulët të natës dhe 12.52 cent gjatë pjesës tjetër të ditës. Kjo nënkupton një dyfishim të tarifave. Këto masa, deri më sot, janë të vlefshme deri më 31 mars 2023, pavarësisht riskut që rritjet e mëtejshme të çmimeve të duken pothuajse të pashmangshme dhe mund të duhet të vendosen tarifa të larta ose të rriten subvencionet e energjisë.

43. Sipas Kompanisë Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO) dhe institucioneve të Kosovës, 22-30% e ekonomive familjare konsumojnë më shumë se 800 kWh në muaj (vlerësimi më i ulët është nga KESCO).¹² Ndikimi në buxhet për 70-78 % të ekonomive familjare që konsumojnë më pak se 800 kWh/muaj është se ato do të shpenzonin maksimumi 48 euro në muaj mbi shumën e mëparshme. Në përgjithësi, institucionet e Kosovës vlerësojnë se kjo masë do të rezultonte në një rritje të çmimit që varion nga 5%-30% (duke supozuar se 60% e konsumit ndodh gjatë ditës). Ndikimi në buxhetin e ekonomive familjare nuk mund të matet me saktësi (marrë parasysh kufizimet e të dhënave dhe të dhënat e SMSJ-së nga viti 2017), pasi që fatura e energjisë është nën vijën e konsumit “banim”, që përfaqësonte mesatarisht 29% të konsumit në një ekonomi familjare në vitin 2017. Pavarësisht se viti 2017 ofron një pikë referimi të dobët, bazuar në të dhënat e vitit 2017, rreth 60% e shtëpive urbane të Kosovës paguanin ndërmjet 10% dhe 30% të të hyrave të tyre familjare për konsumin e energjisë elektrike në vitin 2013, dhe kostoja për ekonomitë familjare më të varfra për një rritje të konsiderueshme të çmimeve të energjisë mund të çojë në një rritje deri në 40-50% për ekonomi familjare të caktuara.^{13 14} Nivelet e përdorimit të energjisë përtej kufirit 800 kWh mund të supozohet se u atribuohen ekonomive familjare me të hyra të larta, të cilat mund ta përballojnë më lehtë çmimin e rritur. Andaj, për të rrafshuar kurbën e kërkesës dhe për të inkurajuar eficiencën e energjisë, institucionet kanë krijuar një skemë të re që synon të rimbursojë një pjesë të faturës së energjisë nëse konsumi është më i ulët në krahasim me vitin e kaluar.

44. Dy kërkesa u bënë në TM3-TM4 2022 në ZRRE nga Kompania Kosovare për Distribim të Energjisë Elektrike në Kosovë (KEDS) për dyfishim të mëtejshëm të faturave të energjisë për ekonomitë familjare, si për konsumin e ulët ashtu edhe për atë të lartë. Kërkesa e parë më 29

¹² <https://balkangreenenergynews.com/kosovo-doubles-electricity-prices-for-households/>

¹³ https://www.rit.edu/research/cenr/sites/rit.edu.research.cenr/files/2013_03_01_cenr_kosovo_household_energy_consumption.pdf

¹⁴ “Housing” item as share of overall consumption has been rounded up here to 30%.

gusht u refuzua, por njëkohësisht ndërmjet 15 gushtit dhe fillimit të shtatorit 2022, institucionet e Kosovës vendosën ndërprerjet e planifikuara të rrymës, duke reduktuar 25% të orëve të furnizimit me energji në 24 orë (d.m.th. vetëm 18 orë furnizim ditor) dhe në këtë mënyrë induktuan kursime të energjisë, përtej vetë-rregullimit/reduktimit të kërkesës nga ekonomitë familjare. Ndërkohë që mbetet për t'u parë nëse kërkesa e dytë (5 dhjetor) do të merret parasysh nga ZRRE-ja, mospërputhja e gjenerimit dhe konsumit të ardhshëm ka gjasa të çojë në ndërprerje të energjisë (siç ishte rasti tashmë në dimrin 2021/2022), të shoqëruara me vështirësi teknike me termocentralet e vjetëruar.

45. Me institucionet që kanë ndarë tashmë 100 milionë euro për të zbutur ndikimin e çmimeve më të larta të energjisë për qytetarët, kufiri i G7 për çmimet e energjisë ruse i ndjekur nga një ndalim rus për shitjen në vendet që zbatojnë hendekun, do të çojë në krizën më të madhe energjetike me të cilën përballlet Evropa që nga viti 1972. Marrë parasysh se Kosova është në shumë mënyra marrëse e çmimeve dhe se kostot shtesë të energjisë i gërryejnë më tej të hyrat e disponueshme, ka gjasa të ketë subvencione shtesë të energjisë. Në tetor 2022, BE-ja u zotua të ofrojë një mbështetje të mëtejshme buxhetore prej 75 milionë eurosh për të reduktuar ndikimin e çmimeve të ngritura të energjisë në Kosovë, duke u fokusuar në targetimin e bizneseve dhe ekonomive familjare të cenueshme, me fokus të veçantë në promovimin e efikasitetit të energjisë. Kjo mbështetje është si shtesë e mbështetjes më të gjerë prej 500 milionë eurosh për rajonin për të mbështetur tranzicionin drejt pavarësisë energjetike dhe sigurisë së furnizimit, duke fokusuar në burimet e ripërtërishtme dhe lidhshmërinë e tregut të energjisë.

NDIKIMI I ÇMIMEVE TË USHQIMEVE NË EKONOMITË FAMILJARE


46. Kërkesa për energji e përdoruesit fundor është përgjithësisht më elastike, ndërsa nivelet e konsumit të ushqimeve (përfshirë zëvendësuesit më të lirë dhe më pak ushqyes) kanë prirje të ruhen. Zëvendësimi, megjithëse i mundshëm, përcaktohet nga një gamë e gjerë faktorësh, duke përfshirë normat kulturore dhe gjinore, për shembull.

47. Çmimet e ushqimeve filluan të rriten mbi nivelet historike që nga gushti 2021, duke vazhduar një trend të fortë rritës nga nëntori 2021 (në 6.7%) deri në 20% në korrik 2022. Në afat të shkurtër, rritjet e shpejta të çmimeve të ushqimeve mund të supozohet se transferohen drejtpërdrejt në një reduktim të të hyrave të disponueshme (pak kohë dhe mundësi për efektet e zëvendësimit). Marrë parasysh peshën e tyre në buxhetin e konsumit të ekonomive familjare (në 40%), kjo do të rezultonte në rritjen e buxhetit të konsumit në 48% të totalit (duke e ulur për 8% buxhetin e disponueshëm). Grafiku 3 tregon rritjen e qëndrueshme të inflacionit të çmimeve të ushqimeve duke filluar nga korriku i vitit 2021, në trajektore pothuajse të drejtë deri në korrik 2022, me fillimin e luftës që duket se ka pasur vetëm një ndikim modest në rritjen e çmimeve.

¹⁵ https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/statement_22_6422

GRAFIKU 3. INFLACIONI MUJOR I ÇMIMEVE TË USHQIMEVE (NË %) QË NGA JANARI 2020


Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit



48. Fuqia blerëse e ekonomive familjare ndikohet negativisht nga efekti i kombinuar i çmimeve të derivateve/energjisë dhe ushqimeve, siç përshkruhet në grafikun 4 më poshtë. Indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumit – me vitin 2015 si bazë indeksi – që variojnë nga viti 2010 deri në nëntor 2022, tregojnë rritjen më të madhe të çmimeve për më shumë se një dekadë, me nivelet mujore të inflacionit në nivelet e vitit 2022 të parë për herë të fundit në gusht 2010.

GRAFIKU 4. INDEKSET E HARMONIZUARA TË ÇMIMEVE TË KONSUMIT (2010-2022)

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, Indekset e Harmonizuara të Çmimeve të Konsumit



49. Efekti i kombinuar i rritjes së çmimeve të energjisë dhe ushqimeve në buxhetin e ekonomive familjare mund të vlerësohet ndërmjet 9.5% dhe 18% të shpenzimeve. Varfëria energjetike në Kosovë ekzistonte para krizës aktuale. Një studim i vitit 2021 nga Komuniteti i Energjisë i BE-së (EnC) për Adresimin e Varfërisë Energjetike vë në dukje se çmimet e energjisë elektrike në Kosovë për konsumatorët familjarë duke përfshirë të gjitha taksat dhe detyrimet janë ndër më të ulëtat në Komunitetet e Energjisë, pra 21% më të ulëta se mesatarja në palët kontraktuese të EnC, dhe se politikat e dekarbonizimit do të çojnë në presion në rritje mbi çmimet e energjisë. Në mesin e nëntë palëve kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, Kosova ka përqindjen më të madhe të ekonomive familjare që jetojnë në varfëri energjetike, deri në 40 %, dhe Mali i Zi më të ulët, ndërmjet 8 dhe 15%, sipas një studimi për adresimin e varfërisë energjetike në anëtarët e Komunitetit të Energjisë.


50. Si përfundim, ndërkohë që ndikimi i krizës së fundit ndihet shumë më tepër nga grupet me të hyra të ulëta, shumica e të cilëve do të përjetojnë stres të konsiderueshëm ekonomik tani dhe gjatë dimrit, një tranzicion i suksesshëm energjetik për të përmbushur caqet e Agjendës së Gjelbër të BE-së dhe dekarbonizimit bart riskun që ta rrisë edhe më tej varfërinë energjetike. Edhe pse shumë familje do të mbrohen pjesërisht nga flukset e remitançave, trendi rritës dhe rezilient i remitançave mund të mos vazhdojë, sigurisht nëse Gjermania dhe ekonomitë e tjera përjetojnë dhimbje të mëtejshme ekonomike, gjë që duket se do të ndodhë teksa BQE-ja vazhdon shtrëngimin e kapitalit. Një krizë e zgjatur mbarëbotërore që rezulton në rritje të mëtejshme të çmimeve të mallrave bazë ka gjasa të rrisë kursimet, duke reduktuar përdorimin e remitançave për më shumë mallra dhe shërbime luksoze, dhe kjo do të ndikojë në produktivitet. Si rezultat, politikat e Kosovës do të duhet të fokusohen në rritjen e reziliencës së grupeve me të hyra të ulëta, ndoshta përmes një shporte të subvencioneve dhe lehtësimeve tatimore.

NDRYSHIMET NË REMITANCAT

51. Përkundër parashikimeve të FMN-së dhe Bankës Botërore se vlera e remitançave globale kërcënohej nga COVID-19, realiteti është se remitancat mbeten shumë të larta, duke demonstruar vlerën e shtuar të të paturit të një komuniteti të fortë të diasporës për të mbrojtur ekonomitë familjare nga goditjet e brendshme me origjinë ekzogjene. Të dhënat e disponueshme tregojnë se të hyrat nga remitancat janë rritur në mënyrë të qëndrueshme duke filluar nga maji 2020, duke vënë në dukje një rënie gjatë periudhës janar-mars 2022, për t'u rritur sërish me rritjen e ndikimit të krizës së çmimeve të ushqimeve dhe energjisë në tetor 2022. Grafiku 5 më poshtë tregon trendin e përgjithshëm, i cili duket se do të zgjatet më tej në vitin 2022, duke treguar një rritje mes tremujorit të dytë dhe tremujorit të tretë të vitit 2022.

GRAFIKU 5. REMITANCAT SIPAS KANALIT (2021 (TM1) DERI NË 2022 (TM3)) (MILION EURO)


Burimi: Banka Qendrore e Kosovës.



52. Në terma financiarë, të hyrat nga remitancat në gjashtëmuorin e parë të vitit 2022 u vlerësuan në 552.6 milionë euro, vetëm 1.8 milionë më pak se i njëjti gjashtëmuor i vitit 2021, por sërish më të larta se të gjithë tremujorët e mëparshëm nga viti 2018 e në vazhdim. Remitancat mbeten një burim kryesor i reziliencës për ekonomitë familjare, për BPV-në dhe për servisimin e bilancit tregtar. Marrë parasysh presionin e shtuar në monedhat e huaja për eksportet energjetike, një kolaps i remitancave do të kishte një ndikim shkatërrues në radhë të parë mbi ekonomitë familjare dhe pastaj edhe në stabilitetin makroekonomik. Grafiku 6 më poshtë e ilustron këtë gjetje që premtan mirë për flukset afatmesme për të mbështetur ekonomitë familjare me të hyra të ulëta për të kompensuar ndikimin e një kostoje të lartë jetese.

GRAFIKU 6. TOTALI I REMITANCAVE SIPAS GJASHTËMUJORIT (2018-S1 2022) (MILION EURO)

Burimi: BQK, Tabela 32, dhe Llogaritjet e Geopolicy.




NDIKIMI NË BPV DHE BILANCIN TREGTAR

53. BPV-ja në TM3 2022 shënoi rritje reale për 2.07% krahasuar me TM3 2021. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), gjatë periudhës raportuese, aktivitetet financiare dhe të sigurimit janë rritur për 12.67%; Veprimtaritë shkencore, profesionale dhe teknike; Aktivitetet e shërbimeve administrative dhe mbështetëse (8.61%); Informacioni dhe komunikimi (8.28%); Arte, argëtim dhe rekreacion, aktivitete të prodhimit të mallrave shtëpiake për përdorim vetanak dhe shërbime të tjera (7.49%); Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave, Transporti dhe magazinimi, Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit (4.31%); Industria minerare dhe prodhuese, furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të klimatizuar, Furnizimi me ujë, aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbetjeve dhe rehabilitimi (2.24%); Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi (2.18%); dhe Aktivitetet e pasurive të paluajtshme (1.38%). Aktivitetet ekonomike që shënuan rënie në tremujorin e tretë ishin Ndërtimtaria (-7.78%); dhe Administrata publike, sigurimet shoqërore, arsimit dhe shëndetësia (-0.48%). Eksporti i mallrave dhe shërbimeve u rrit për 6.30%, importi i mallrave dhe shërbimeve për 3.87%, shpenzimet për konsumin final për 2.64%, dhe formimi i kapitalit bruto u ul për 2.33%.¹⁶ BPV-ja në TM2 2022 shënoi rritje reale për 2.14% krahasuar me TM2 2021. Grafiku 7 më poshtë paraqet aktualet nominale të BPV-së për periudhën 2018-2021 me rritjen e parashikuar për 2022-2026 bazuar në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KAMSH) 2023-2025 të MFPT-së dhe me rishikimet më të fundit nga FMN-ja dhe BB-ja. Që nga publikimi i KAMSH-it në prill 2022, parashikimet janë rregulluar nga institucionet financiare, çka tregon ndikimin e rëndësishëm në ekonomi.

¹⁶ <https://ask.rks-gov.net/media/7214/gross-domestic-product-gdp-of-the-expenditure-and-production-approach-q3-2022.pdf>

GRAFIKU 7. AKTUALET (2018-2021) DHE PARASHIKIMET (2022-2026) E BPV-SË NOMINALE

Burimi: KAMSH 2023-2025 i MFPT-së (prill 2022) duke përfshirë projeksionet e përditësuara nga FMN/BB.




54. Kosova ka ekspozim shumë të kufizuar ndaj tregtisë së drejtpërdrejtë me Ukrainën dhe Rusinë. Të dhënat tregojnë se deficitit tregtar u rrit nga 361.1 milionë euro në nëntor 2021 në 401.4 milionë euro në nëntor 2022, duke shënuar një rritje për 11.2%. Gjithashtu, eksporti i mallrave në nëntor 2022 është vlerësuar në 73.9 milionë euro, ndërsa importet janë vlerësuar në 475.4 milionë euro, që është një rritje për 4.6% në eksporte dhe 10.1% në importe, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021. Si eksportet ashtu edhe importet me BE-në u rritën përkatësisht për 32.3% dhe 7.8%.

55. Teksa ndikimi në BPV nuk u prek negativisht bazuar në rezultatet e TM3, është shumë herët për të bërë ndonjë supozim mbi ndikimet në TM1 2023 kur mungesat dhe kostot e energjisë do të jenë në kulmin e tyre. Në maj të vitit 2022, FMN-ja vlerësoi se ndikimi i inflacionit të çmimeve të energjisë dhe ushqimeve në importet e Kosovës mund të ishte deri në 5.5% të BPV-së, ose një ndikim prej 550 milionë eurosh, që do të çonte gjithashtu në ngadalësimin e pritur të rritjes së BPV-së që në daljen nga pandemia. Megjithatë, grafiku 7 paraqet BPV-në tremujore (milion euro me çmime aktuale) për periudhën TM1 2021 deri në tremujorin e tretë për vitin 2022, me mesatare të thjeshta lëvizëse për dy tremujorë të aplikuar për TM4 2022.

GRAFIKU 8. BPV TREMUJORE (MILION EURO) ME ÇMIMET AKTUALE

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës



NDRYSHIMET NË TË ARDHURA DHE SHPENZIME

56. Ndërkohë që performanca më e fortë fiskale ua ka lejuar institucioneve qendrore ta zbutin ndikimin e kushteve të goditjes tregtare tek ekonomitë familjare dhe firmat, duke i rimbushur edhe tamponët e likuiditetit¹⁷ dhe megjithëse buxheti i Kosovës për vitin 2023 parasheh rritje të konsiderueshme të të ardhurave¹⁸, hapësira aktuale fiskale është e pamjaftueshme për të financuar investime të reja madhore si tranzicioni i ekonomisë digjitale, tranzicioni energjetik ose Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 (OZHQ-të). Për të akomoduar prioritetet e reja të shpenzimeve në vitin 2022, shpenzimet kapitale janë reduktuar, duke ndikuar me gjasë në rezultatet e rritjes, dhe performanca e ulët në shpenzime ka lejuar që deficitin fiskal të mbetet gjerësisht brenda rregullës fiskale. Nevojat për financim institucional qendror, siç përshkruhet në buxhetin e vitit 2023, nuk përfshijnë këto vija me shpenzime të mëdha.

57. Ndryshimet nga viti në vit tregojnë se të ardhurat u zgjeruan mes TM3 2021 dhe TM3 2022 dhe shpenzimet institucionale gjithashtu u rritën ndjeshëm, si rezultat i rritjes së mbrojtjes sociale dhe subvencioneve të energjisë në veçanti. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, të ardhurat e përgjithshme institucionale në TM3 2021 ishin 673.9 milionë euro, dhe nga viti në vit u rritën për 3.5% (ose 23.6 milionë euro) në 697.5 milionë euro. Pjesa më e madhe e të ardhurave përbëhet nga taksat në produkte, të cilat përfaqësojnë 78% të të ardhurave totale, taksat rrjedhëse në të hyra 14%, pagesat për produktet jo-komerciale 4%, dhe transfere të tjera rrjedhëse 3%, ndërsa pjesa tjetër shpërndahet në kategoritë të tjera të të ardhurave.¹⁹ Grafiku 9 paraqet të ardhurat sipas burimit për periudhën TM1 2020 deri në fund të TM3 2022, duke treguar një rritje të taksave në produkte (rritje në TVSH dhe taksa për detyrimet e importit).


¹⁷ <https://www.imf.org/en/News/Articles/2022/11/04/Kosovo>

¹⁸ <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/FB8AED72-35CD-4636-BAB5-D675B2967296.pdf>

¹⁹ https://ask.rks-gov.net/media/7187/Ilogarit%C3%AB-qeveritare-t%C3%AB-kosov%C3%ABs-tm3_2022.pdf

GRAFIKU 9. TË ARDHURAT E PËRGJITHSHME INSTITUCIONALE (ESA2010) (TM1 2020 DERI TM3 2022)

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës




58. Gjatë të njëjtës periudhë, shpenzimet e përgjithshme institucionale u rritën nga 526.9 milionë euro në TM3 2021 në 615.9 milionë euro TM3 2022, një rritje për 16.9% (89 milionë euro) nga viti në vit. Pjesa më e madhe e shpenzimeve përbëhet nga kontributet dhe benefitet sociale, të cilat përfaqësojnë 24%, subvencionet 23%, kompensimi i punonjësve që përfaqëson 23%, konsumi i ndërmjetëm 13%, ndërsa pjesa tjetër shpërndahet në kategoritë e tjera të shpenzimeve. Kostoja e shërbimeve të përgjithshme institucionale u rrit nga viti në vit nga 82.0 milionë euro në 125.5 milionë euro dhe shpenzimet për mbrojtjen sociale u rritën nga 133.0 milionë euro në 149.2 milionë euro. Këto kategori të shpenzimeve ka gjasa të rriten më tej në TM4 2022 dhe TM1 2023. Me rritjen e të ardhurave shumë më të ngadaltë se të shpenzimeve (potencialisht të përkohshme), deficitet fiskale dhe buxhetore mund të rriten.

59. Grafiku 10 më poshtë jep një përmbledhje të shpenzimeve të përgjithshme institucionale nga TM1 2020 deri në TM3 2022, duke treguar një rritje të përgjithshme të shpenzimeve për kontributet dhe benefitet sociale, konsumin e ndërmjetëm dhe subvencionet në veçanti, megjithëse këto vija mbeten nën pikun nga të dyja valët I dhe II të COVID-19. Gjithashtu, janë zvogëluar asetet dhe detyrimet financiare.

60. Ndryshimet në përbërjen e shpenzimeve për periudhën TM1-TM3 2019-2022 janë paraqitur në grafikun 11 më poshtë, duke treguar një rritje të ndjeshme të shpenzimeve sociale dhe subvencioneve krahas një rënie masive të formimit të kapitalit bruto. Një rezultat i tillë do të çonte në një parashikim të rritjes së stresit makro-fiskal.


GRAFIKU 10. SHPENZIMET E PËRGJITHSHME INSTITUCIONALE BAZUAR NË ESA2010 (MILION EURO)

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës



GRAFIKU 11. NDRYSHIMI NË PËRBËRJEN E SHPENZIMEVE 2019, 2021 DHE TM1-TM2 2022

Burimi: MFPT e Kosovës



61. Buxheti i vitit 2023 ofron një bazë për të kuptuar supozimet e punës së institucioneve të Kosovës në vazhdim. Megjithatë, teksta rezultatet e rritjes së BPV-së sipas projeksioneve për vitin 2022 nuk janë realizuar dhe marrë parasysh se duket e pamundur një ndërprerje e afërt e luftës në Ukrainë, në një kontekst ku Kosova duhet të bëjë më shumë sesa të balancojë buxhetin, por edhe të investojë në energji të shtrenjta dhe tranzicione digjitale, hapësira fiskale ekzistuese është e pamjaftueshme. Përkundër fitimeve të konsiderueshme të realizuara nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), sipas projeksioneve për periudhën 2023-2025, kombinimi i përmirësimit të administratës tatimore me kosto më të larta të energjisë do të ndikojë në sektorin privat. Projekcioni për gjithsej borxhin është 23.7% e BPV-së deri në fund të 2025-ës me deficitin buxhetor që lëviz nga -3.9% në 2022 në 0.1% në 2025. Megjithatë, rritja e shpenzimeve kapitale për të përmbushur si tranzicionin energjetik ashtu edhe atë digjital – pa llogaritur OZHQ-të – krahas kostove më të larta të huamarrjes, çmimeve më të larta të energjisë dhe presioneve në rritje ndaj mbrojtjes sociale dhe subvencioneve, do t'i sfidojnë këto projeksione.

TABELA 5: PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE TË INSTITUCIONEVE PËR BUXHETIN E KOSOVËS 2023

Përshkrimi	2020	2021	2022 Rishikimi	2023 Proj.	2024 Proj.	2025 Proj.
Në milionë euro:						
1. Gjithsej të ardhura [1]	1,722.2	2,200.9	2,430.4	2,884.1	2,982.2	3,196.1
1.1 Të ardhura tatimore	1,507.0	1,947.9	2,168.9	2,525.4	2,684.9	2,885.4
Tatime të drejtpërdrejta	267.2	342.2	392.6	504.5	513.6	550.6
Tatimi në të hyrat e korporatës	85.3	113.9	136.2	192.9	206.2	221.1
Tatimi në të hyrat personale	158.0	189.5	212.7	263.0	257.2	277.5
Tatimi në pasurinë e paluajtshme	22.7	36.3	41.0	44.6	45.9	47.4
Tjetër	1.3	2.4	2.7	4.0	4.3	4.5
Tatime të tërthorta	1,272.7	1,664.7	1,837.8	2,097.3	2,252.5	2,422.1
Tatimi mbi vlerën e shtuar:	770.1	1,038.2	1,176.0	1,387.3	1,495.8	1,612.3
Vendor:	222.4	291.7	360.0	435.9	462.8	493.8
Kufiri:	547.8	746.5	816.0	951.4	1,033.0	1,118.5
Detyrimet doganore	101.6	124.6	134.3	138.9	150.8	163.3
Akciza	398.1	501.3	524.9	570.6	605.4	645.8
Të tjera të tërthorta	2.9	0.6	2.6	0.5	0.6	0.6
Rimbursime të tatimeve	-33.0	-58.9	-61.5	-76.4	-81.2	-87.3
1.2 Të ardhura jo tatimore	181.2	236.1	239.1	261.2	274.7	288.2
Tarifa, ngarkesa dhe të tjera	146.2	186.8	188.5	208.5	220.6	234.4
Tarifa, ngarkesa dhe të tjera						
- Qendrore	103.5	129.6	142.1	154.6	164.0	175.0
Tarifa, ngarkesa dhe të tjera						
- Niveli lokal	42.7	57.3	46.4	53.9	56.6	59.5
Tarifa koncesionare	2.7	17.0	17.0	19.0	21.0	21.0
Renta	29.4	19.2	30.2	30.2	30.1	30.1
Divident	0.00	10.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Të hyra nga interesi	3.0	3.1	3.4	3.5	3.0	2.7
1.3 Grante	43.1	16.8	22.5	97.5	22.5	22.5
Nga të cilët: Grante nga						
BE-ja për energjinë	0.0	0.0	0.0	75.0	0.0	0.0


2. Gjithsej shpenzime [1]	2,234.9	2,299.3	2,898.2	3,211.7	3,219.6	3,323.8
2.1 Shpenzime rrjedhëse	1,827.7	1,837.6	2,140.8	2,342.1	2,270.7	2,341.9
Paga dhe mëditje	660.8	667.3	670.9	745.5	749.9	756.3
Mallra dhe shërbime	299.2	327.7	403.8	493.1	494.8	508.3
Subvencione dhe transfere	867.8	842.6	1,045.0	1,098.0	1,021.2	1,072.5
Rezerva rrjedhëse	0.0	0.0	21.0	5.4	4.8	4.8
2.2 Shpenzime kapitale	379.7	419.8	704.4	810.7	885.7	913.0
Financimi i rregullt buxhetor	261.2	399.8	570.1	681.4	768.4	771.4
Financimi i borxhit përmes klauzolës së investimit	47.1	20.0	113.2	129.4	117.3	141.6
Të ardhurat e likuidimit (AKP)	71.5	0.0	21.0	0.0	0.0	0.0
2.3 Interesi i borxhit publik	27.5	32.186	41.1	46.9	51.2	56.9
2.4 GPD - Grantet e përcaktuara nga donatorët	9.2	9.7	12.0	12.0	12.0	12.0
3. Bilanci i Buxhetit (1-2)	-512.7	-104.2	-466.5	-326.0	-236.0	-126.4
4. Shpenzimet e përjashtuara nga rregulla fiskale:	148.6	53.9	134.2	129.4	117.3	141.6
Shpenzimet nga të ardhurat e dedikuara	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Shpenzimet e financuara nga THV të bartura komunale	30.1	33.8	0.0	0.0	0.0	0.0
Shpenzimet kapitale nga likuidimi	71.5	0.0	21.0	0.0	0.0	0.0
Shpenzimet kapitale nga klauzola e investimit	47.1	20.0	113.2	129.4	117.3	141.6
5. Bilanci buxhetor, sipas përkufizimit të rregullës fiskale (5+6)	-364.1	-50.3	-332.3	-196.6	-118.7	15.3
A. Nevoja për financim:	-512.7		-466.5	-326.0	-236.0	-126.4
B. Financimi i jashtëm (neto)	139.5		359.9	367.7	123.6	163.4
C. Financimi i brendshëm (neto)	240.8		52.5	56.3	95.6	83.7
D. Ndryshimi në gjendjen e shfrytëzueshme bankare:	-132.5		-54.1	98.1	-16.8	120.8
E. Stoku i bilancit të shfrytëzueshëm bankar (neto)	235.5		258.7	293.8	277.0	397.8
F. Fondet e përcaktuara, Saldo	94.5		129.5	129.5	129.5	129.5
G.BILANCI BRUTO BANKAR I FUNDIT TË VITIT	330.0		388.1		406.5	527.2
Të ardhurat e pranuar nga ATK	466.9	597.7	711.6	895.8	930.5	996.9
Të ardhurat e pranuar nga rimbursimet e detyrimeve doganore	-33.0	-58.9	-61.5	-76.4	-81.2	-87.3
Flukset hyrëse nga GPD-të	9.0	16.8	12.0	12.0	12.0	12.0
Flukset dalëse nga GPD-të	9.2	9.7	12.0	12.0	12.0	12.0
BPV-ja	6,771.6	7,957.9	8,593.9	9,842.9	10,605.2	11,400.6
Deficiti buxhetor (përcaktimi i rregullës fiskale) si % e BPV-së	-5.4%	-0.6%	-3.9%	-2.0%	-1.1%	0.1%
Bilanci bankar i disponueshëm si % e BPV-së	3.5%	3.9%	3.0%	3.0%	2.6%	3.5%
Memo 2:						
Stoku i borxhit të brendshëm	961.9	1,106.1	1,226.1	1,232.1	1,352.1	1,472.1
Stoku i borxhit të jashtëm +garancitë)	525.8	576.9	925.9	955.4	1,069.7	1,226.0
Garancitë e Kosovës	31.7	30.6	29.6	28.6	3.6	2.6
Gjithsej borxhi si % e BPV-së	22.4%	21.5%	25.4%	22.5%	22.9%	23.7%

INDEKSI I ÇMIMEVE TË MALLRAVE BAZË

62. Çmimet veç ishin në rritje para luftës, si rezultat i krizës COVID-19 dhe intervenimeve fiskale të lidhura me të. Në vitin 2021, lufta në Ukrainë e përkeqësoi situatën, me rritje të madhe të çmimeve në tregjet e mallrave bazë, duke i çuar çmimet e ushqimeve në nivel rekord dhe gazin natyror në nivelet më të larta historike. Çmimet për grurin, një element kryesor në të cilin Rusia dhe Ukraina së bashku përbëjnë rreth një të katërtën e eksporteve globale, u rritën për 54% në mars 2022 nga një vit më parë. Që atëherë janë ulur, por janë ende shumë mbi nivelet e çmimeve të vitit 2021.²⁰ Me importet e ushqimeve dhe energjisë nga këto burime të ndërprera, dhe me vendet e tjera që vendosin ndalimin e eksporteve, vendet përballesh me kosto të larta dhe pasiguri rreth furnizimeve. Kosova nuk bën përjashtim. Grafiku 12 më poshtë paraqet ndryshimet mujore të çmimeve për Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) (totali dhe vija të zgjedhura) në Kosovë, nga viti 2018 deri në nëntor 2022. Çmimet e artikujve ushqimorë, veçanërisht të drithërave, rritja e të cilëve filloi në tremujorin e tretë të vitit 2021, kanë vazhduar të rriten ndjeshëm gjatë vitit aktual. E njëjta gjë vlen edhe për çmimin e transportit i cili ndikohet drejtpërdrejt nga rritja e çmimeve të derivateve (dhe dëshmoi një hov në fund të verës), dhe banimin.

GRAFIKU 12. NDRYSHIMET MUJORE TË IHÇK-SË SIPAS GRUPEVE KRYESORE JANAR 2018-NËNTOR 2022 (NË %)

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës



NDRYSHIMET NË ÇMIMET E MALLRAVE BAZË

63. Indeksi i çmimeve të importit në Kosovë është rritur për 1.7% në TM3 2022 krahasuar me TM2 2022. Krahasuar me TM3 2021, çmimet e importit u rritën mesatarisht për 17.5%. Të renditura sipas magnitudës dhe sektorit, produktet minerale u rritën për 52.8%; produktet e gurit, llaçi, qeramika dhe çelqi (41.2%); vajrat ushqimorë (37,0%); druri dhe artikujt prej tij (30.3%); plastika, goma dhe artikujt prej tyre (18.9%); produkte bimore (18,8%); kafshë të gjalla dhe prodhime

²⁰ <https://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

shtazore (15.3%); metale bazë dhe artikuj prej metaleve bazë (11.5%); këpucë (10.5%); ushqime të përgatitura, pije dhe duhan (9.0%); mjetet e transportit (9.0%); letra dhe artikuj prej tyre (8.4%); tekstile dhe artikuj prej tyre (7.2%); pajisje makinerish dhe pajisje elektrike (6.6%); produktet e industrive kimike (4.9%); artikuj të ndryshëm të përpunuar (4.5%); dhe instrumente optike, fotografike, matëse, mjekësore dhe muzikore dhe mekanizma të orëve (1.8%).²¹

NDRYSHIMET NË ÇMIMET E PRODHIMIT

64. Indeksi i çmimeve të prodhimit në Kosovë është rritur për 11.3% në TM3 2022 krahasuar me TM2 2022. Krahasuar me TM3 2021, çmimet e prodhimit u rritën mesatarisht për 17.2%. Rritja më e madhe sipas degëve të aktivitetit ekonomik vërehet në: furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të klimatizuar (49.7%); prodhimi i letrës dhe artikujve prej saj (14,3%); prodhimi i produkteve ushqimore (14,2%); prodhimi i pajisjeve elektrike (11.6%); prodhimi i artikujve prej kashte dhe materiale të endura-thurura (9.4%); prodhimi i makinerive dhe pajisjeve (8.2%); prodhimi i produkteve metalike të fabrikua, përveç makinerive dhe pajisjeve (8.1%); prodhimi i produkteve minerale jo-metalike (7.3%); prodhimi i metaleve (6.1%); prodhimi i pijeve (5.7%); prodhimi i produkteve prej lëkure dhe artikujve prej tyre (5.3%); prodhimi i produkteve të gomës dhe plastike (4.7%); grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë (3.8%); prodhimi i produkteve kimike (2.8%); xehe të tjera dhe gurore (1.5%); dhe prodhimi i mjeteve motorike (transport), rimorkio dhe gjysmërimorkio (0.1%). Rritja balancoi rënien e çmimeve të nxjerrjes së mineralit metalik për -28.8% dhe prodhimit të mobiljeve (-7.3%).²²

²¹ <https://ask.rks-gov.net/media/7182/import-price-index-ipi-q3-2022.pdf>

²² <https://ask.rks-gov.net/media/7192/producer-price-index-ppi-q3-2022.pdf>

5

PARASHIKIMI STRATEGJIK

65. Analiza e ndikimit e kuantifikuar më lart ofron karakterizimin e një ekonomie të ndikuar nga çmimet më të larta globale të naftës dhe ushqimeve dhe të përkeqësuar nga disa përforcues vendorë: (i) rezilienca e dobët e prodhimit të energjisë vendore (ii) varësia nga importi dhe nivelet e kufizuara të investimeve private jashtë ndërtimtarisë, çka i kufizon shumëfishuesit e rritjes, si dhe lidhjet kritike përpara dhe prapa.

66. Teksa konsumi dhe eksportet e shërbimeve të nxitura nga diaspora mbeten shtytësit kryesorë të rritjes, nivelet e varfërisë, sistemi i mbrojtjes sociale që u nënshtrohet reformave, pjesëmarrja e ulët në fuqinë punëtore (veçanërisht e punëtorëve femra) dhe varësia nga tregu rajonal i energjisë, i përcaktojnë ndjeshëm cenueshmërinë dhe reziliencën ndaj goditjeve të jashtme. Përveç cenueshmërive ekzistuese, të cilat nuk po shfaqeshin qartë për shkak të stimulit fiskal prej 3.2% të BPV-së që e ngriti ekonominë gjatë COVID-19²³, dhe bazuar në trajektoren e çështjeve ndërkombëtare globale rreth luftës në Ukrainë, çështjet e mëposhtme të parashikimit strategjik do të duhet të diskutohen nga institucionet e Kosovës për sa i përket përcaktimit të prioritetëve afatshkurtra dhe afatmesme të politikave, investimeve, shpenzimeve dhe zbutjes. Krahas një faturë në rritje për importet që ka gjasa të çojë në një përkeqësim të mëtejshëm të deficitit të llogarisë rrjedhëse (DLLRR), rritje të deficiteve fiskale dhe buxhetore, si dhe realitetin që mund të përkeqësohet ndikimi në Ballkanin Perëndimor dhe Evropë i luftës në Ukrainë, çështjet e përshkruara më poshtë do të mbeten të rëndësishme për politikëbërësit edhe për ca kohë në të ardhmen.

SHTRËNGIMI GLOBAL I KAPITALIT RRIT KOSTON E HUAMARRJES

67. Megjithëse tregjet financiare të Kosovës mbeten të vogla dhe mjaft të cekëta, rritja e kostos së kredisë si rezultat i shtrëngimit të kapitalit ka gjasa të ndikojë në normat e huamarrjes dhe profitabilitetin e sektorit privat. Në korrik, Banka Qendrore Evropiane (BQE) njoftoi se norma e interesit për operacionet kryesore të rifinancimit dhe normat e interesit për instrumentin e kreditimit margjinal dhe instrumentin e depozitave do të rriten përkatësisht në 0.50%, 0.75% dhe 1.00%, me efekt nga 27 korriku 2022. Deri më 27 tetor 2022, BQE njoftoi më tej se norma e interesit për operacionet kryesore të rifinancimit dhe normat e interesit për instrumentin e kreditimit margjinal dhe instrumentin e depozitave do të rriten përkatësisht në 2.00%, 2.25% dhe 1.50%, me efekt nga 2 nëntori 2022.

68. Teksa politikëbërësit e vendeve anëtare të BE-së përballen me sfidën e frenimit të inflacionit pa komplikuar ngadalësimin ekonomik dhe rritur risqet e mospagimit të borxhit, normat më të larta të interesit do të ngadalësojnë investimet dhe do të reduktojnë flukset e investimeve në fushat kyçe të ekonomisë. Me humbjen e terrenit të euros ndaj dollarit amerikan vetëm në vitin

²³ <https://www.worldbank.org/en/country/kosovo/overview#3>

2022, kostoja e importeve në të gjithë Eurozonën e ka rritur inflacionin për shumë mallra bazë kritike. Në një kontekst të tillë, dhe ku janë reduktuar shpenzimet kapitale të institucioneve qendrore, do të duhet të mbikëqyren nga afër risqet e hapësirës së reduktuar fiskale dhe potenciali për huamarrje më të madhe. Teksa tranzicioni energjetik dhe kostot e përmbushjes së OZHQ-ve të Agjendës 2030 nuk janë zbrëthyer me kosto, në Bosnjë dhe Hercegovinë (për shembull), kostoja parashikohet në dhjetëra miliarda euro.

69. Bashkimi Evropian ka sjellë Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane për të përmirësuar jetën dhe për të larguar ekonominë nga derivatet fosile dhe industrinë me përdorim intensiv të gazrave serë, si dhe për të zbutur kostot socio-ekonomike të tranzicionit. Agjenda 2030 e mbështet këtë agjendë dhe tranzicionin e ekonomisë digjitale, i cili sërish vjen me shpenzime të konsiderueshme. Si për tranzicionin energjetik ashtu edhe për atë digjital, dhe marrë parasysh hapësirën e kufizuar fiskale dhe shpenzimet e ulëta kapitale, grumbullimi i kapitalit privat do të jetë esencial që për të dy tranzicionet të sigurohen burime të mjaftueshme. Kjo do të kërkojë forma të ndryshme të financimit të përzier përtej Partneriteteve Publike Private (PPP) që të përfshijnë financimin katalitik të humbjes së parë, garancitë dhe marrëveshjet e transferimit të riskut për shembull.

70. Mësimi kyç është se adresimi i inflacionit është një thikë me dy tehe. Ulja e inflacionit do të thotë rritje e normave të interesit që ndikon në kostot e huamarrjes, servisimin e borxhit dhe nivelet e investimeve. Në një kohë kur ka nisur dekarbonizimi dhe Marrëveshja e Gjelbër e BE-së, kombinimi i krizës energjetike (duke i shtyrë shtetet anëtare të BE-së drejt varësisë më të madhe nga gjenerimi konvencional) dhe rritjes së kostove të financimit, do të ndikojë në aftësinë për të paguar të ekonomive familjare me të hyra të ulëta në Kosovë.

SKENARËT E ARDHSHEM TË KOSTOVE TË ENERGJISË

71. Çmimet e ardhshme të energjisë dhe ushqimeve janë të vështira për t'u vlerësuar, pjesërisht për shkak se oferta dhe kërkesa globale luhaten, por edhe sepse ndryshimet klimatike kanë ndikime të pabarabarta. Teksa FMN-ja parashikon se çmimet ndërkombëtare të energjisë pritet të mbeten mbi nivelet e tyre të paraluftës për të ardhmen e parashikueshme dhe se rritja e kostove të energjisë dhe perspektiva më e dobët do të ndikojnë në cilësinë e aseteve dhe të ardhurat e firmave, mbështetja në vazhdim dhe e ardhshme nga BE-ja është planifikuar t'i zbusë kostot në rritje të energjisë dhe të mbrojtjes së biznesit dhe konsumatorët. Masa të tilla mbështetëse kalimtare pritet të vazhdojnë.

72. Ajo që është e qartë për Kosovën është se zëvendësimi i dy termocentraleve të vjetëruara me thëngjill (Kosova A dhe B) në kontekstin e një tranzicioni drejt një të ardhme me energji të pastër, përfshin një tranzicion sfidues të miksit energjetik në një kohë kur goditjet nga ana e furnizimit nga Rusia i kanë ndërprerë importet kritike. Me rritjen e kërkesës rajonale dhe globale për energji përballë një të ardhmeje të pasigurt nga ana e ofertës,²⁴ dhe me investimet në energjinë solare (KfW do të japë një grant prej 31.5 milionë eurosh, WBIF do të japë një grant prej 21.5 milionë eurosh dhe BERZH do të japë hua 23.2 milionë euro për të financuar impiantin 100 megavat) që duan vite të tëra që të shkallëzohen, kalimi në gjenerimin e pavarur vendor nuk do të jetë i lehtë dhe racionimi i energjisë mund të bëhet normalja e re, duke ndikuar në produktivitet dhe të hyra. Skemat e mundshme të reduktimit të ngarkesës do të duhet të përshtaten për të pasqyruar ndryshimet në sistemin e prodhimit të energjisë, teksa edhe ai është në tranzicion.

²³ Pas rënies për rreth 1% në vitin 2020 për shkak të ndikimeve të pandemisë Covid-19, kërkesa globale për energji elektrike pritet të rritet për afër 5% në 2021 dhe 4% në 2022 – e nxitur nga rimëkëmbja ekonomike globale – sipas edicionit të fundit të Raportit gjashtëmujor të Tregut të Energjisë Elektrike të IEA-së.

Ndërkohë, nëse nuk rivendoset paqja në Ukrainë, sigurimi i së ardhmes energjetike të Kosovës do të zgjasë pesë vjet ose më shumë, duke ndikuar në rritjen afatmesme dhe rezultatet e prosperitetit.

KRIZA MUND TË SFIDOJË KONTRATËN DHE KOHEZIONIN SOCIAL

73. Me nivele të larta të papunësisë dhe përjashtimit social mes pakicave dhe grupeve të cenueshme, teksa sistemi i mbrojtjes sociale u nënshtrohet reformave, mund të humbet përparimi në uljen e niveleve të varfërisë, duke e dëmtuar kohezionin social. Në të njëjtën kohë, shpenzimet e mbrojtjes sociale dhe subvencionet e energjisë për grupet me të hyra të ulëta do të rriten në mënyrë të pashmangshme, duke reduktuar hapësirën fiskale, duke dëmtuar investimet kritike në Agjendën e Rivendosjes së Madhe, Revolucionin e Katërt Industrial (4IR), tranzicionin e industrisë 4.0 dhe tranzicionet e ekonomisë digjitale dhe të gjelbër. Duhet të rritet mbështetja për kohezionin etnik dhe social dhe duhet të përshpejtohet reforma e sistemit të mbrojtjes sociale dhe pensioneve.

A SJELL KRIZA TË MIRA TË PAPRITURA PËR AGJENDËN E GJELBËR DHE AGJENDËN 2030?

74. Megjithëse në pamje të parë kriza aktuale duket se na shpërqendron nga zbatimi i Agjendës së Gjelbër dhe Agjendës 2030, realiteti është se çështjet e ngritura nga këto agjenda janë nxjerrë në qendër të skenës nga kriza aktuale. Nevoja për Agjendën e Gjelbër për të financuar tranzicionin energjetik nuk ka qenë kurrë më urgjente dhe objektivat e shumta të vendosura përmes OZHQ-ve ofrojnë matje të dobishme për institucionet qendrore për të investuar drejt një të ardhmeje më pak të cenueshme dhe më shumë reziliente.

6

SKENARËT DHE PROJEKSIONET

75. Bazuar në analizën diagnostike të kryer dhe të paraqitur pjesërisht më lart, janë parashikuar pesë variabla si më poshtë (i) inflacioni i çmimeve të ushqimeve (ii) inflacioni i çmimit të energjisë (iii) skenarët e çmimeve të materialeve (iv) skenarët e rritjes dhe fiskale dhe (v) shpenzimet institucionale. Supozimet për skenarët jepen në Tabelën 6 më poshtë, me një përshkrim të mëtejshëm në seksionin e skenarit përkatës më poshtë:


TABELA 6: SUPOZIMET E SKENARIT	
Skenari 1 (mesatarja për 10 vjet)	Trendi aktual vazhdon (inflacioni), dhe institucionet qendrore ruajnë stabilitetin (vazhdon trendi i 10 viteve të fundit). Projektioni përdor ndryshimin mesatar të çmimeve që nga viti 2011.
Skenari 2 (ndryshimi i çmimeve në 2021)	Inflacioni vazhdon të përkeqësohet, recesion dhe kolaps i shpenzimeve të institucioneve qendrore (përshejtohet me normën për vitin 2021). Projektioni përdor ndryshimin e çmimeve për vitin 2011.
Skenari 3 (Mesatarja 2014-2018)	Kthim në trendet para luftës dhe pas COVID-19 (rifillon trendi i 5 viteve të fundit para COVID). Projektioni përdor mesataren e 5 viteve para Covid (2014-2018).

SKENARËT E ARDHSHËM TË INFLACIONIT TË ÇMIMEVE TË USHQIMEVE

76. Inflacioni i çmimeve të ushqimeve jepet në grafikun 13 më poshtë dhe bazohet në ndryshimin mesatar të çmimit për 10 vite sipas projekcionit deri në vitin 2026. Të dhënat historike janë nxjerrë nga indeksi i harmonizuar i çmimeve të mallrave bazë, me çmime historike të ushqimeve nga TM1 2011 deri në fund të T2 2022. Rritjet afatgjata të trendeve për vajrat ushqimorë, qumështin dhe mishin e gjedhit do të sugjerorin rritje të çmimeve të importit që nuk mund të kompensohen menjëherë nga zëvendësimi i importit. Megjithatë, rritja e çmimeve të pulave dhe vezëve mund të kompensohet nga zëvendësimi i importit.

GRAFIKU 13. ÇMIMET E USHQIMEVE (AKT. 2011-2022) - (PARASHIKIMI 2023-2026 - MESATARJA PËR 10 VJET)


Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, Geopolcity Inc, Projektione



77. Për sa i përket tre skenarëve të aplikuar për procesin e përgjithshëm të harmonizuar të mallrave bazë, grafiku 14 më poshtë jep projeksionet për periudhën 2022-2026. Teksa supozimet nuk mund të testohen kundrejt së ardhmes, si një kombinim ato mbulojnë gamën më të mundshme të eventualiteteve të tregut, edhe duke supozuar se paqja nuk do të rivendoset në Ukrainë së shpejti. Çka është po aq komplekse për projeksion është ndikimi i shtrëngimit të tregut global të kapitalit dhe ulja e vlerës së euros kundrejt dollarit amerikan, për shembull, marrë parasysh se inflacioni do të vazhdojë të importohet dhe zinxhirët më të shkurtër të furnizimit ka gjasa të vazhdojnë të ushtrojnë presion mbi çmimet.

GRAFIKU 14. ÇMIMET E USHQIMEVE (AKT. 2011-2022) - (PARASHIKIMI 2023-2026) MES. PËR 10 VJET

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, Geopolcity Inc, Projektione



SKENARËT E ARDHSHËM TË ÇMIMEVE TË ENERGJISË


78. Inflacioni i çmimit të energjisë jepet në grafikun 15 më poshtë, bazuar në ndryshimin mesatar të çmimit për 10 vite dhe sipas projeksionit deri në vitin 2026. Përkundër prodhimit të konsiderueshëm të energjisë nga dy termocentralet me thëngjill (Kosova A dhe B) për të përmbushur nevojat e brendshme, duket se do të vazhdojë trendi i rritjes së çmimit të energjisë elektrike nga viti 2020 në 2021, marrë parasysh importet e kushtueshme dhe kohën dhe financat e nevojshme për të ecur drejt miksit të ri energjetik. Ndhmesë do të japin tarifatat nxitëse për energjinë hidrike, erës, fotovoltaike dhe biomasës, së bashku me një mekanizëm ankandi. Teksa Britania e Madhe ndaloi importet e gazit rus nga fillimi i vitit 2023, BE-ja nga ana tjetër nuk ka rënë dakord për ndalimin e gazit rus. Në vend të kësaj, ajo ka sjellë politika për t'u larguar nga varësia prej tij.²⁵ Në nëntor 2022, BE-ja njoftoi një paketë të re të mbështetjes energjetike prej 1 miliardë eurosh për Ballkanin Perëndimor dhe mirëpriti marrëveshjet e reja për ta forcuar tregun e përbashkët rajonal.²⁶ Në një periudhë të tranzicionit energjetik – për të bërë kalimin e energjisë nga gjenerimi konvencional në atë alternativ – financimi i jashtëm do të jetë çelësi për mbarëvajtjen e tranzicionit.

²⁵ <https://commonslibrary.parliament.uk/research-briefings/cbp-9523/>

²⁶ https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_22_6478

GRAFIKU 15. ÇMIMET E ENERGJISË (AKT. 2011-2022) - (PARASHIKIMI 2023-2026 - TRENDI PËR 10 VJET)

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, Geopolicity Inc, Projektione




SKENARËT E ARDHSHËM TË ÇMIMEVE TË MATERIALEVE

79. Të dhënat nga Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Mallrave Bazë në Kosovë flasin për çmime të ngritura që vërtetojnë rritjet universale të çmimeve të mallrave bazë siç tregohet në grafikun 16 më poshtë. Problemi është që materialet ndërtimore, çmimet e energjisë dhe kostot e tjera janë rritur ndjeshëm, e megjithatë çmimet e fuqisë punëtore janë në trend afatgjatë me rritje të ngadaltë, nën shkallën e inflacionit. Marrë parasysh varësinë e Kosovës nga importi për shumë materiale, dhe nën dritën e ndryshimit të regjimit tregtar global dhe zinxhirëve më të shkurtër të furnizimit, kostot e larta parashikohen të rriten për njëfarë kohe, gjatë vitit 2023 dhe më tej, siç tregohet. Presioni ulës në çmime mund të përballohet vetëm nëpërmjet një efekti të fortë të zëvendësimit të importit (i cili është i ndërlikuar) ose rritjes së bashkëpunimit tregtar rajonal që do të ulte tarifatat ndërmjet ekonomive të Ballkanit.

GRAFIKU 16. INDEKSI I ÇMIMEVE TË MATERIALEVE NDËRTIMORE (AKT. E TM 2013-2022, PROJ. E TM4 2022) - (PARASHIKIMI 2023-2026 - TRENDI PËR 10 VJET)

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, Geopolicity Inc, Projektione




SKENARËT E ARDHSHËM TË RITJES DHE FISKALË

80. Projektionet e rritjes së BPV-së janë dhënë në KAMSH 2022-2025, megjithëse me institucionet e Kosovës që projektojnë rezultate më të larta të rritjes sesa Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) ose FMN, dhe me FMN-në që i ul parashikimet e rritjes globale dhe rajonale, 2022 parashikohet të jetë nën performancë me çmime të ngritura që minojnë rritjen reale. Projektionet afatgjata të ofruara nga KAMSH i MFPT-së dhe FMN-ja jepen në grafikun 17 më poshtë, duke treguar dallimin e rëndësishëm ndërmjet institucioneve optimiste të Kosovës dhe rezultateve më realiste të FMN-së.

GRAFIKU 17. KAMSH I MFPT-SË DHE FMN TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET 2012-2021 (AKTUALE) 2022-2026 (PROJEKSIONI) (MILION EURO)


Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës



81. Si rezultat, deficitet buxhetore dhe fiskale duket se do të vazhdojnë të rriten në periudhën afatmesme, me varësinë në rritje nga borxhi i brendshëm, siç tregohet në grafikun 18 më poshtë. Teksa raporti i borxhit publik sipas projeksioneve do të mbetet përgjithësisht i pandryshuar në rreth 24% të BPV-së në vitin 2021 për shkak të rimëkëmbjes së fortë në të ardhurat fiskale dhe ekzekutimit më të ulët seç pritej të shpenzimeve, dhe pavarësisht nga rregulla fiskale që e ankron borxhin në më pak se 40% të BPV-së, kostot afatgjata të tranzicionit energjetik, tranzicionit të ekonomisë digjitale dhe përmbushjes së Agjendës 2030 mund të sjellin rritje të përgjithshme afatgjatë të borxhit.

GRAFIKU 18. PËRBËRJA DHE PROJEKSIONET E BORXHIT PUBLIK (2017-2026)

Burimi: KAMSH i MFPT-së (2023-2025), PRE (2022-2024), Geopolcity Inc, Projektione




SKENARËT E ARDHSHËM TË SHPENZIMEVE INSTITUCIONALE

82. Skenarët e ardhshëm të shpenzimeve institucionale nuk përfshijnë një projeksion për shpenzimet operacionale dhe zhvillimore sipas klasifikimit funksional ose ekonomik, megjithëse këto trende janë raportuar në seksionet e mëparshme. Me rritjen e inflacionit dhe rënien e rritjes, normat e formimit të kapitalit fiks ka gjasa të ndikohen negativisht dhe rritja e kostos së huamarrjes ka gjasa t'i ngadalësojë investimet, edhe nëse mbahet një politikë kundër-ciklike. Grafiku 19 më poshtë paraqet deficitin buxhetor dhe nevojën për financim për periudhën 2019-2025, duke treguar një deficit buxhetor optimist, bazuar në parashikimet për të ardhura të forta të MFPT-së. Megjithatë, nëse vazhdon trendi i vendosur në 2020 dhe 2022, do të duhet të reduktohet ose rritja e borxhit ose shpenzimet për investime drejt rritjes. Me kërkesën për energji në rritje dhe nevojën për të financuar tranzicionin energjetik, krahas rritjes së kostove të financimit, do të duhet të dalin mënyra të reja për financimin e zhvillimit të qëndrueshëm, p.sh. nga sektori privat.²⁷

GRAFIKU 19. DEFICITI BUXHETOR DHE NEVOJAT PËR FINANCIM (2019-2025) (MILION EURO)

Burimet: KAMSH i MFPT-së (2023-2025)



²⁷ Për shembull, "Instrumentet e Borxhit Kontingjent Shtetëror" lidhin pagesat e servisimit të një borxhi sovran me aftësinë e tij për të paguar, ku kjo e fundit është e lidhur me variabla ose ngjarje të botës reale. Instrumentet mund të lidhen me BPV-në e një vendi, me çmimet e mallrave bazë ose me fatkeqësitë natyrore si uraganet ose tërmetet kur kohët janë të këqija – si për shembull gjatë një rënijeje ekonomike si rezultat i luftës në Ukrainë, ka një reduktim automatik të barrës së servisimit të borxhit sovran. Në mënyrë të ngjashme, obligacionet e lidhura me BPV-në janë letra me vlerë të borxhit ose letra me vlerë derivative në të cilën emetuesi i autorizuar (një vend) premtim të paguajë një kthim, përveç amortizimit, që ndryshon me sjelljen e BPV-së. Ky lloj i letrave me vlerë mund të konsiderohet si një "aksion në një vend" në kuptimin që ka karakteristika "të ngjashme me ekuitetin". Pagan më shumë/më pak kur performanca e vendit është më e mirë/më e keqe seç pritej. Mund të hulumtohen instrumente të tjera.

7

MASA PËR RISQET DHE ZBUTJEN

83. Ky vlerësim i ndikimit tregon se si përforcuesit vendorë të cenueshmërisë dhe reziliencës janë pengesë për të ardhmen e rritjes dhe prosperitetit në Kosovë. Kosova nuk i kontrollon çmimet e saj të energjisë, remitancat apo kërcënimet rajonale të sigurisë dhe mbetet shumë e varur nga importi për shkak të mungesës së zhvillimit të hapësirës së produkteve dhe investimeve drejt diversifikimit dhe zhvillimit të tregut kufitar. Si rezultat, faktorët që ndikojnë negativisht në ekonomi nuk mund të kontrollohen nga institucionet qendrore të Kosovës, me çmimet e energjisë dhe ushqimeve, remitancat dhe stabilizimin rajonal dhe rregullimet e sigurisë që janë përtej ndikimit të tyre. Megjithatë, institucionet e Kosovës mund të ndikojnë në ritmin e tranzicionit energjetik, modernizimin e sistemit të mbrojtjes dhe mirëqenies sociale, përbërjen e subvencioneve dhe stimujve, dhe kornizën e investimeve për të krijuar një shoqëri më reziliente, duke pranuar varësi komplekse rajonale.

RISQET PARËSORE

84. Teksa risqet e tjera janë dokumentuar, vlerësimi nxjerr në pah risqet madhore të mëposhtme për domenin socio-ekonomik, qytetarët dhe institucionet (shih Tabelën 7 më poshtë).

TABELA 7: RISQET PARËSORE ME TË CILAT PËRBALLET KOSOVA NGA KRIZA E UKRAINËS	
Kërcënimet	Përshkrimi
Pasiguria energjetike	Institucionet qendrore kanë aftësi të kufizuar ose aspak aftësi për të ndikuar në kostot e energjisë në një afat të shkurtër dhe ritmi i ngadaltë i tranzicionit të brendshëm energjetik siguron që të mbeten cenueshmëritë aktuale energjetike, në rastin më të mirë deri në afat të mesëm. Në prill 2022, çmimi mesatar për megavat-orë (MWh) në HupX tejkaloi 200 euro në krahasim me 55 euro në të njëjtën javë të vitit 2021, duke nënvizuar ndikimin shkatërrues që ritmi i ngadaltë i reformës energjetike po ka tani tek konsumatorët. Teksa janë duke u zhvilluar investimet për kalimin e gjenerimit drejt një miksi të ri energjetik, ky tranzicion do të kishte qenë e dobishme të fillonte shumë vite më parë, duke e vënë Kosovën në pozitë që të arrijë t'i minimizuar nevojat për furnizim të jashtëm, dhe potencialisht të jetë eksportuese neto. Kostoja e furnizimit me energji përballohet nga ekonomitë familjare, dhe megjithëse subvencionet e energjisë do të duhet të dyfishohen ose trefishohen gjatë 6-12 muajve të ardhshëm, po kështu edhe investimet në infrastrukturën e re për gjenerim do t'i reduktojnë ngadalë kufizimet e furnizimit.
Sfidat e rritjes	Me ngadalësimin e rritjes së rimëkëmbur pas COVID-19 në vitin 2020, rritja u mbështet nga subvencionet fiskale dhe rritja e kostos së energjisë dhe ushqimeve ka pasur ndikim të rëndësishëm në skenarët e ardhshëm të rritjes në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme. Sfidat e rritjes kanë shumëfishues negativë në punësim, barazi, mbrojtje sociale dhe kohezion social, dhe mund të kërkohet mbështetje fiskale e jashtme shtesë nga BE, FMN dhe Banka Botërore për ta balancuar buxhetin dhe për t'i përmbushur nevojat në rritje për shpenzime sociale.

Rritja e kostos së subvencioneve	Subvencionet e energjisë dhe rritja e pagesave të ndihmës sociale për ata që përballen me kosto të larta jetese, u dyfishuan mes TM3 2021 dhe TM3 2022, dhe ndoshta më të keqen pritet ende të vijë. Përveç faturës prej 100 milionë eurosh për subvencionimin e energjisë (pasi që mbështetja buxhetore e BE-së prej 75 milionë eurosh nuk i prek financat e Kosovës), do të rriten kostot e subvencioneve, në një kohë kur janë rritur shpenzimet e përgjithshme institucionale. Kjo do të ndikonte në borxhin institucional, në një kohë me norma më të larta interesi. Megjithatë, ekziston një rregull fiskale e vendosur me FMN-në dhe institucionet po i kthehen shpenzimeve brenda rregullës fiskale në vitin 2023.
Kohezioni social	Presionet ekonomike shpesh transmetohen përmes sfidave ndaj kontratës sociale dhe kohezionit social. Ekzistojnë risqe afatgjata për dobësimin e kohezionit social, të cilat nuk duhen nënvlerësuar. Nuk duhet të përjashtohet mundësia e demonstratave kundër institucioneve qendrore, dhe investimet në ruajtjen e stabilitetit social përmes subvencioneve (për shembull) do të mbeten të një rëndësie të shtuar.

MASAT PËR ZBUTJE

85. Implikimet e menjëhershme të situatës aktuale për institucionet e Kosovës ndikojnë në fushën fiskale, të shpenzimeve, të politikave sociale, të politikës energjetike dhe të financimit të zhvillimit. Siç ndodhi gjatë COVID-19, institucionet e Kosovës do të duhet të jenë proaktive në trajtimin e çështjeve para se ato të shfaqen, në vend që të reagojnë. Shumë nga çështjet e parashikimit strategjik ka gjasa të shfaqen në shkallë të ndryshme dhe, marrë parasysh krizën aktuale në Evropë dhe në të gjithë zonën euro, mbështetja e jashtme ka gjasa të jetë më e tendosur, duke nënkuptuar nevojën që akterët vendorë të drejtojnë reformat e politikave, energjisë dhe tregut financiar, dhe kapitali privat do të jetë kyç për të përmirësuar financimin për të siguruar tranzicionin kompleks. Për më tepër, marrë parasysh nevojën për një politikë të rishikuar të mbrojtjes sociale, do të jetë e rëndësishme vendosja e masave përpara shfaqjes së ndikimeve negative sociale. Si rezultat, propozohen masat e mëposhtme për zbutje (shih Tabelën 8), si pjesë e një qasje proaktive për të minimizuar risqet e ardhshme dhe detyrimet kontingjente.

TABELA 8: MASAT E PROPOZUARA PËR ZBUTJE

Masat për zbutje	Përshkrimi
Pasiguria energjetike	Prodhimi aktual i energjisë është kryesisht nga termocentralet e vjetëruara me thëngjill (Kosova A dhe Kosova B), por edhe nga Ujmani dhe hidrocentrale të tjera, të gjitha në pronësi të institucioneve qendrore. Kosova ka të instaluar kapacitete gjeneruese prej 1,431 megavat (MW), duke përfshirë kapacitetet gjeneruese të ripërtërishme. Megjithatë, kapaciteti operativ konsiderohet të jetë 1,099 MW, nga të cilat termocentralet me thëngjill përbëjnë rreth 87.36%, dhe pjesa tjetër përbëhet nga hidrocentrali i Ujmanit me 2.91%, impianti me erë i Kitkës me 2.95% dhe burime të tjera të ripërtërishme (hidrocentrale, panelet solare dhe impiante me erë), të cilat përbëjnë 5.43 % të gjenerimit total gjatë vitit 2021 (Eurostat, 2021). ²⁸ Është me rëndësi jetike rritja e investimeve për të mbështetur sigurinë energjetike përmes Agjendës së Gjelbër të BE-së dhe stimujve të tjerë tatimorë dhe jo-tatimorë, duke përfshirë qartësinë

²⁸ <https://bankwatch.org/blog/narrow-road-ahead-the-energy-crisis-in-kosovo-in-the-context-of-russia-s-invasion-of-ukraine>

	<p>se si të kalohet miksi energjetik (nga varësia nga prodhimi i bazuar në thëngjill) në një sistem më rezilient dhe të vetë-qëndrueshëm, duke mobilizuar kapitalin publik dhe privat. Për më tepër, me fokus në tranzicionin e gjelbër, duke njohur kufizimet me të cilat përballet Kosova në marrjen e një vlerësimi ndërkombëtar të kredisë, obligacionet e gjelbra dhe ato të OZHQ-ve mund të emetohen me shpejtësi për të financuar tranzicionin, me stimuj për ulje të riskut dhe kapital katalitik të humbjes së parë, kapital privat që do të kërkohet për gjenerim dhe shpërndarje në rrjet dhe jashtë rrjetit. Strategjia e Energjisë (2022-2031) që adreson sigurinë e furnizimit duhet të zbatohet në mënyrë efektive. Rritja e efikasitetit të energjisë dhe promovimi i ndërtesave me energji pothuajse zero e lidh strategjinë e energjisë me ekonominë reale.</p>
Sfidat e rritjes	<p>Duhet të reduktohet varësia e madhe nga remitancat, konsumi dhe eksportet e shërbimeve të nxituara nga diaspora përmes inkurajimit të kapitalit privat për të nxitur diversifikimin, intensifikimin dhe rritjen e nxitur nga eksporti në të ardhmen. Rritja e flukseve të kapitalit privat, përmirësimi i pjesëmarrjes në tregun e punës, vazhdimi i rritjes së fortë të kreditimit, përdorimi më i mirë i remitancave dhe tërheqja e rritjes së investimeve të huaja direkte dhe flukseve hyrëse të portofolit, duhet të mbeten qendrore për përmirësimin e rezultateve të rritjes. Për të vazhduar rritjen, Kosova duhet të çlirojë fitimet e produktivitetit dhe të krijojë më shumë vende pune cilësore, të adresojë pengesat në infrastrukturë, t'u japë përparësi investimeve në kapitalin njerëzor, si dhe të sigurojë rritjen e konkurrueshmërisë dhe zhvillimin e sektorëve me potencial të lartë. Rritja e produktivitetit të firmave, rritja e produktivitetit të fermave, rritja e eksporteve dhe rritja e konkurrueshmërisë dhe investimeve private, janë me rëndësi jetike. Si një importues neto i ushqimeve, inputeve bujqësore dhe energjisë, përmirësimi i qëndrueshmërisë së tregut në këto fusha duhet të forcojë fokusin e politikave, edhe pse bujqësia do të vazhdojë të bëhet një funksion në rënie të rritjes.</p>
Sfidat fiskale	<p>Ruajtja dhe rritja e hapësirës fiskale nuk ka qenë kurrë më kritike, marrë parasysh një ndikim negativ të pritshëm në të ardhurat e ardhshme dhe rritjen e presionit në subvencionet e përgjithshme institucionale dhe të lidhura me energjinë dhe shpenzimet sociale. Nëse hapësira fiskale mbetet shumë e ngushtë, marrë parasysh kapacitetin e kufizuar për huamarrje në treg, do të ndikohen investimet në energji dhe rritja e diversifikuar (reziliente). Do të jetë e nevojshme të vihet fokusi në efikasitetin e administratës publike, ndërmarrjeve në pronësi të institucioneve dhe mbrojtjes sociale, si dhe rritja e kapaciteteve për partneritete publike-private dhe përzierje, marrë parasysh bazën e kufizuar tatimore dhe nivelet potencialisht në rritje të informalitetit. Një strategji afatmesme e të ardhurave duhet të mbetet objektivi numër një i politikës, për të përfshirë fokusin në formalizimin dhe kursimet fiskale në të gjitha shpenzimet publike dhe rritjen e hapësirës për investime të sektorit privat.</p>
Kohezioni social	<p>Dialogu ndërmjet palëve të interesit dhe komuniteteve do të jetë gjithnjë e më i nevojshëm, duke nënkuptuar një lëvizje drejt një mënyre të re pune të përcaktuar më mirë si një qasje e gjithë shoqërisë për të ndërtuar më mirë në të ardhmen. Është e rëndësishme të investohet në dialogun social, barazinë sociale dhe hapësirën e drejtësisë sociale, për të minimizuar riskun që çështjet e papajtuara të dalin në plan të parë.</p>



REKOMANDIME

86. Ndikimet, risqet dhe masat e propozuara zbutëse të përfshira këtu dalin nga një vlerësim i ndikimeve të matshme që rezultojnë nga kriza e Ukrainës me fokus në faktorët e përshkruar në fushëveprimin e punës. Ndërkohë që projeksionet do të duhet të përditësohen rregullisht, të mbështetura nga të dhënat e tremujorit të dytë dhe të tretë, tashmë janë formuar trendet në zhvillim që rezultojnë nga kriza dhe këto dokumentohen këtu. Remitancat po rriten, ashtu si borxhi i brendshëm, inflacioni dhe subvencionet, dhe pagat do të mbeten të ngecura deri në zbatimin e ligjit të ri që rregullon pagat publike.

87. Gjatë kërkimit të rrugës nëpër udhëkryqe dhe tranzicione të ndryshme, institucionet qendrore duhet të sjellin kapital privat kudo që të jetë e mundur dhe të përdorin fondet e BE-së përmes zgjidhjeve të përziera që e heqin riskun dhe i përshpejtojnë tranzicionet energjetike dhe të tjera. Aktualisht, këto tranzicione nuk janë zbërthyer me kosto të plota të kushtëzuara dhe teksa borxhi publik është i qëndrueshëm dhe deficit i fiskal mbetet brenda kufijve, në vijim do të kërkohet një strategji dhe qasje e re për investime në Kosovë. Meqenëse Marrëveshja e Gjelbër dhe elementët kyç të Agjendës 2030 mbeten qendrore për integrimin në BE, nevojiten mënyra të reja për përafrimin e sistemit të investimeve publike të Kosovës me taksonominë e BE-së për aktivitete të qëndrueshme. Marrë parasysh punën e UNDP-së me BE-në për INFF (Kornizat e Integruara Kombëtare të Financimit) për ta promovuar këtë agjendë, mundësitë për bashkëpunim më të thellë në hapësirën e financimit të qëndrueshëm duken të nevojshme dhe urgjente.

88. Marrë parasysh nevojën që institucionet e Kosovës dhe partnerët ndërkombëtarë ta përdorin këtë punë për të informuar një politikë proaktive dhe agjendë investimi, është e qartë se çdo rivendosi do të duhet të fokusohet në tranzicionin energjetik dhe zhvillimin e tregut, diversifikimin dhe intensifikimin e rritjes, mbrojtjen sociale dhe investimet në promovimin e kohezionit social, kontratës sociale, si dhe rritjen e gjenerimit të të ardhurave institucionale dhe kapaciteteve mobilizuese. Për të kompensuar sfidat fiskale afatgjata, do të nevojiten grumbullimi i kapitalit privat dhe instrumenteve të kombinuara të financimit për të financuar tranzicionin energjetik, megjithëse të mbështetur nga Agjenda e Gjelbër e BE-së. Për të gjetur rrugën në tranzicionin kompleks të ardhshëm, flukset e reja të burimeve duhet të integrohen në PRE - veçanërisht kapitali privat - dhe partnerët ndërkombëtarë do të duhet të ofrojnë mbështetje katalitike dhe për ulje të riskut. Nëse tranzicioni nuk financohet sa duhet, do të mbeten cenueshmëritë dhe do të komprometohet rezilienca.

89. Problemet dhe sfidat e shumta të evidentuara këtu do të ishin cak i natyreshëm për një tranzicion drejt zgjidhjeve më inovative dhe të qëndrueshme të financimit, të cilat tani janë të nevojshme për të siguruar tranzicionin e ardhshëm. Futja në përdorim e një gjenerate të re të instrumenteve inovative dhe të qëndrueshme të financimit duhet të jetë thelbi i politikës, përndryshe do të rriten grumbujt e borxhit të brendshëm dhe shpenzimet institucionale do të ngecin në një cikël vicioz.

ANNEX 1: DATA AND STATISTICAL ANNEX

Përbërja dhe nivelet e Borxhit Publik të Kosovës (2017-2022 (Projeksioni))										
	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026
Borxhi ndërkombëtar	422.2	416.4	409.1	525.8	576.8	578.7	619.7	663.6	710.6	761.0
Borxhi i brendshëm	574.3	676.6	791.9	961.9	1106.1	1137.5	1306.2	1500.0	1722.5	1977.9
Garancitë e Kosovës	44.0	43.7	42.7	31.7	30.6	30.1	33.1	36.3	39.8	43.7
Gjithsej borxhi (% e BPV-së) MFPTTotal	16.37	17.04	17.63	22.44	21.92	25.50	27.20	28.70	28.70	28.70
Gjithsej borxhi (% e BPV-së) FMN		17.00	17.70	24.30	24.30	25.30	26.10	26.90	27.80	29.00
Gjithsej borxhi	996.4	1093.1	1201.1	1487.7	1682.9	1716.2	1925.9	2163.6	2433.1	2738.9

BURIMI: PRE 2022- 2024 Kosovë

Të ardhurat e përgjithshme institucionale bazuar në ESA2010											
Përshkrimi ESA	2020 TM1	2020 TM2	2020 TM3	2020 TM4	2021 TM1	2021 TM2	2021 TM3	2021 TM4	2022 TM1	2022 TM2	2022 TM3
Taksa në produkte	295.5	278.5	337.1	367	336.6	395.5	485	437.9	394.4	427.2	547.3
TVSH	171.5	157.1	194.4	216	201.9	237.7	282.5	262.3	250.4	267.2	332.8
Taksa dhe detyrime në importe	116	114.8	132.8	140.7	125.1	146.7	190.5	164.5	133.1	148.9	201.1
Detyrimet e importit	25.3	21.9	28.1	31.5	24.9	29	37.1	35.7	27.5	32.6	37.8
Taksa në importe pa TVSH dhe detyrime	90.7	93	104.7	109.2	100.2	117.7	153.3	128.9	105.6	116.3	163.3
Taksa në produkte përveç TVSH-së dhe taksave të importit	8	6.6	9.9	10.3	9.5	11.1	12.1	11.1	10.9	11	13.3
Taksa të tjera në produkte	11.3	9.8	13.3	10.7	13	4.5	12.2	10.5	20.2	12	15.4
Të hyrat nga prona	-	7.2	-	7.2	6.2	8.9	14.5	13.3	2.1	9.5	11
Taksat rrjedhëse në të hyra, pasuri, etj.	63.9	60	68.9	71.7	73.1	94.8	82.3	80.3	96.1	112	94.8
Transfere të tjera rrjedhëse	5.7	6	15.5	31.2	14.9	9.9	8.6	10.4	10.4	10.8	20.2
Asete dhe detyrime finaciare	2.8	213.8	57.5	189.2	58.9	122.3	42.7	44.4	12.2	37.2	18.9
Pagesa për produkte jo të tregut (Shitjet)	23.3	11.9	20.3	26.2	20.9	24.2	28.6	30.3	22.2	26.5	27.7
Gjithsej	402.4	587.2	512.6	703.2	523.6	660	673.9	627.1	557.6	635.2	697.5

Shpenzimet e përgjithshme institucionale bazuar në ESA2010

Përshkrimi ESA	2020 TM1	2020 TM2	2020 TM3	2020 TM4	2021 TM1	2021 TM2	2021 TM3	2021 TM4	2022 TM1	2022 TM2	2022 TM3
Kompensimi i të punësuarve	154.7	172.1	164	170.6	169.8	162.3	154.4	161.5	160	160.5	142.7
Subvencione	16.7	24.2	25.8	173.2	46.6	26.6	42.2	105.1	26.3	55.1	140.9
Të hyra nga pro-na, të pagueshme	9.1	4.4	8.4	5.6	8.5	6.4	9.2	6.7	9.7	7.2	10.3
Kontribute dhe benefite sociale	133	187.8	179.1	173.7	150.1	138.1	134.7	196.2	145	180.9	150.1
Transfere të tjera rrjedhëse	4	7.6	9	10.7	8.3	9.9	11.5	22.7	8.7	12.3	10.6
Transfere të kapitalit	0.9	5.7	7.2	4.7	0.3	3.6	2.6	3.2	0	33.4	1.2
Asete dhe detyrime financiare	15.4	25.3	27.1	49.3	22.8	24.2	29	56.2	20	10.9	10.4
Blerjet minus disponimet e aseteve jo të prodhuara	1.2	1.6	12.5	5.3	2.8	1.6	2.7	14.8	13.9	10.1	11.6
Konsumi i ndërmjetëm	40.3	47.2	52.4	88.6	59.8	77.7	71.2	125.2	58.1	80.3	79.6
Bruto formimi i kapitalit	25	59.1	94.4	135.4	52	55.4	69.2	130.8	18	31	58.6
Gjithsej	400.3	534.9	579.8	817.1	521	505.9	526.9	822.6	459.7	581.7	615.9

BPV nominale (milion euro) 2018 – 2021 (Aktualet) – 2022-2026 (Projeksioni)

	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026
BPV nominale (MFPT)	6,672.0	7,056.0	6,772.0	7,817.0	8,754.0	9,621.3	10,407.8	11,156.4	11,491.1
BPV nominale (FMN)	6,672	7,056	6,772	7,637	8,568	9,212	9,815	10,400	10,712.0
Shkalla e rritjes reale (%) (MFPT)	3.60	5.60	-5.30	10.50	5.70	7.10	6.20	6.10	6.3
Shkalla e rritjes reale (%) (FMN)	3.60	5.60	-5.30	-9.50	2.80	3.90	4.10	3.90	4.0

Burimi: KAMSH 2023-2025 i MFPT-së (prill 2022)

Deficiti buxhetor dhe nevojat për financim (2019-2025)

	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Gjithsej të ardhura (1)	1,882	1,722	2,201	2,430	2,676	2,864	3,047
Gjithsej shpenzime (2)	2,093.00	2,234.00	2,299.00	2,898.00	2,974.00	3,113.00	3,203.00
Deficiti buxhetor	-205.00	-512	-104	-466	-297	-248	-154

KAMSH (2022-2024)

Flukset hyrëse të remitançave - sipas kanaleve (në milionë euro, statistikat e fluksit)

Përshkrimi	Neto flukset hyrëse të remitançave	Kanali bankar	Shërbimet e transfereve	Kanale të tjera
Janar	62.3	10.1	29.6	22.6
Shkurt	63.3	5.9	34.5	22.9
Mars	61.7	7.3	41.2	13.2
Prill	60.3	8.8	51.5	n.a.
Maj	104.0	15.4	88.6	n.a.
Qershor	82.9	12.6	59.0	11.3
Korrik	92.3	15.0	69.3	8.1
Gusht	81.6	13.5	59.5	8.5
Shtator	88.3	13.7	64.8	9.9
Tetor	99.6	11.9	59.1	28.5
Nëntor	88.3	12.1	58.4	17.9
Dhjetor 2020	95.3	15.0	56.6	23.7
Janar	69.3	10.3	41.2	17.7
Shkurt	76.8	9.6	46.8	20.4
Mars	96.8	13.5	60.8	22.6
Prill	90.5	13.5	64.8	12.1
Maj	113.3	14.1	69.0	30.2
Qershor	107.7	16.0	60.2	31.5
Korrik	102.5	20.1	49.6	32.7
Gusht	110.2	20.1	45.6	44.5
Shtator	94.7	15.1	58.5	21.1
Tetor	94.8	14.5	58.0	22.2
Nëntor	89.5	15.2	56.5	17.8
Dhjetor 2021	107.3	16.7	53.0	37.6
Janar	70.5	14.9	42.4	13.3
Shkurt	76.2	12.0	49.2	15.0
Mars	94.7	15.1	61.7	17.8
Prill	108.1	14.6	66.7	26.9
Maj	101.1	15.3	58.4	27.4
Qershor	104.9	17.4	61.2	26.4
Korrik	114.9	23.6	57.4	33.8
Gusht	131.6	22.4	55.6	47.4
Shtator	102.6	17.1	62.6	22.9
Tetor (p)	104.4	15.5	64.6	24.3
Dhjetor 2020 (p)	93.7	15.0	62.4	16.3

Ndryshimet mujore të IÇK-IHÇK sipas grupeve kryesore të COICOP

	2021 -01	2021 -02	2021 -03	2021 -04	2021 -05	2021 -06	2021 -07	2021 -08	2021 -09	2021 -10	2021 -11	2021 -12	2022 -01	2022 -02	2022 -03	2022 -04	2022 -05	2022 -06	2022 -07	2022 -08	2022 -09	2022 -10	2022 -11
IHÇK total	0.5	0.7	0.4	0.3	-0.2	0.0	0.8	1.2	0.1	1.0	1.2	0.5	0.9	1.1	2.7	1.5	0.9	1.4	0.9	0.3	-0.2	0.9	0.3
Ushqime dhe pije jo alkoolike	0.8	1.0	0.1	0.7	-0.6	-0.6	0.0	1.8	0.3	0.6	2.8	1.0	1.5	1.9	3.1	2.5	1.2	-0.3	2.1	0.6	0.3	1.6	0.6
Pije alkoolike, duhan	1.2	0.7	0.8	0.6	-0.4	-0.9	1.1	0.4	0.2	0.1	-0.5	1.3	0.2	-0.5	0.2	2.1	0.3	0.6	1.0	-0.4	0.2	1.0	-0.4
03. Veshmbathje	0.5	1.5	1.4	0.2	-0.2	-0.5	0.1	-0.4	-0.1	-0.5	-0.4	-0.9	-0.8	0.4	3.0	-0.8	0.6	0.2	-0.3	-2.6	0.4	1.6	-2.6
Banim, ujë, energji elektrike, gaz dhe derivate të tjera	-3.5	-0.1	0.1	-0.4	-0.1	3.6	0.2	0.7	0.4	1.7	1.5	0.7	0.1	0.1	6.3	-1.7	-1.3	1.0	1.7	0.7	2.1	1.6	0.7
05. Mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtja rutinore e shtëpisë	-0.4	0.7	-0.2	-0.1	0.5	-0.1	0.4	0.5	0.4	0.1	0.6	0.6	0.3	0.5	0.6	1.4	0.7	0.6	0.8	0.5	1.5	0.4	0.5
06. Shëndetësia	0.3	0.0	-0.2	0.1	0.0	0.0	0.0	0.1	-0.1	0.5	0.3	0.1	0.5	-0.1	0.6	0.1	0.1	0.5	0.0	0.2	-0.3	0.1	0.2
Transporti	1.7	0.9	1.8	0.3	0.1	0.2	3.4	2.5	-0.4	3.7	-0.2	-1.1	1.1	1.8	5.0	1.8	2.2	7.3	-2.3	0.0	-3.0	0.2	0.0
08. Komunikimi	-0.2	0.0	0.1	0.1	0.0	-0.3	-0.1	0.4	-0.1	0.1	0.1	0.1	0.0	-0.1	-0.1	0.3	-0.1	0.2	-0.1	0.1	-0.2	0.2	0.1
09. Rekreacion dhe kulturë	0.5	0.2	0.0	0.2	-0.1	0.6	1.8	0.5	-1.3	-1.0	-0.3	0.5	0.5	0.2	0.4	0.2	0.4	0.2	3.9	0.3	-2.4	-1.0	0.3
10. Arsimi	1.0	0.0	0.0	0.0	-0.1	0.0	0.0	0.0	0.7	0.0	0.0	0.1	0.7	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	-0.5	0.0	0.3	0.0	0.0
11. Restorante dhe hotele	0.8	0.2	0.1	0.0	0.0	0.1	0.3	-0.1	0.7	0.4	1.9	1.4	1.2	0.6	0.9	1.3	0.5	2.1	1.9	0.1	0.1	0.2	0.1
12. Mallra dhe shërbime të përziera	0.4	0.6	-0.1	0.1	0.1	0.0	-0.1	0.0	0.7	0.3	0.1	0.5	0.3	0.4	0.3	0.6	0.1	0.7	0.3	0.5	0.2	0.7	0.5

IÇK-IHÇK sipas COICOP për Ushqimet dhe pijet joalkoolike

	2021 -01	2021 -02	2021 -03	2021 -04	2021 -05	2021 -06	2021 -07	2021 -08	2021 -09	2021 -10	2021 -11	2021 -12	2022 -01	2022 -02	2022 -03	2022 -04	2022 -05	2022 -06	2022 -07	2022 -08	2022 -09	2022 -10	2022 -11
IÇK-IHÇK	110 .2	111. 3	111. 4	112. 1	111. 5	110. 8	110. 8	112. 8	113. 1	113. 8	117. 0	118. 1	119. 9	122. 1	125. 9	129. 0	130. 6	130. 2	133. 0	134. 5	134. 9	137. 0	137. 9
Ndryshimi mujor	0.8	1.0	0.1	0.7	-0.6	-0.6	0.0	1.8	0.3	0.6	2.8	1.0	1.5	1.9	3.1	2.5	1.2	-0.3	2.1	0.6	0.3	1.6	0.6

VLERËSIMI I NDIKIMIT TË KRIZËS SË UKRAINËS NË KOSOVË

Një ushtrim
i Parashikimit
Strategjik duke përfshirë
projeksione të bazuara në
skenarë

Dhjetor 2022



**Vlerësimi i
ndikimit të
krizës së
Ukrainës
në Kosovë**

**Një ushtrim i
Parashikimit
Strategjik
duke përfshirë
projeksione
të bazuara në
skenarë**

**Dhjetor
2022**